	<p><b>I.3 Qeniet e gjalla dhe mjedisi</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Qeniet e gjalla ndërveprojnë mes vete dhe me mjedisin jetësor. Mjesdise jetësore të qenieve të gjalla janë pylli, livadhi, lumi, këneta etj., të cilat ndryshojnë nën veprimin e faktorëve natyrorë dhe njeriut.</li> <li>• Në pyll jetojnë së bashku lloje të ndryshme të bimëve dhe shtazëve të varura mes vete dhe nga kushtet fizike të pyllit.</li> <li>• Njeriu sëmurët nga sëmundje të ndryshme, shkaktarë të të cilave janë gjallesat shumë të imëta, të cilat nuk shihen me sy (mikrobet). Në natyrë, përpos këtyre mikrobeve të</li> </ul>	<p>lumi, këneta etj.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të dallojë komponentet e gjalla dhe jo të gjalla të një mjedisi jetësor.</li> <li>- Të emërtojë bimët dhe shtazët karakteristike të pyllit</li> <li>- Të përshkruajë se bimët në pyll prodhojnë ushqimin për vete dhe për të gjithë organizmat e tjerë, se disa shtazë ushqehen vetëm me bimë, të tjerat vetëm me shtazë, kurse disa të tjera edhe me bimë edhe me shtazë.</li> <li>- Të përshkruajë se mjediset jetësore u nënshtrohen ndryshimeve sezonale dhe veprimit të njeriut kurse bimët dhe shtazët reagojnë në këto ndryshime (rënia e gjetheve, lulëzimi, mugullimi, gjumi dimëror, migrimi, shtegtimi ose zhdukja e tyre).</li> <li>- Të përshkruajë se sëmundjet e ndryshme të njeriut shkaktohen nga gjallesat e imëta të cilat nuk shihen me sy (mikrobe) dhe se këto barten përmes njerëzve dhe shtazëve,</li> <li>- Të vlerësojë rolin e higjienës trupore në evitimin e sëmundjeve ngjitëse.</li> </ul>	
--	---	---	---	--

		<p>dëmshme, ekzistojnë edhe mikrobe të dobishme për njeriun dhe natyrën.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Për zhvillimi dhe rritjen normale të organizmit njeriut i nevojitet ushqimi i llojlojshëm dhe aktiviteti fizik trupor.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të tregojë se disa sëmundje ngjitëse fitohen vetëm një herë gjatë jetës , kurse parandalimi i tyre bëhet përmes vaksinimit.</li> <li>- Të klasifikojë mikrobet në natyrë në të dëmshme dhe të dobishme.</li> <li>- Përshkruajë rëndësinë e ushqimit të llojlojshëm dhe të aktivitetit fizik për zhvillimin dhe rritjen e drejtë të organizmit të njeriut dhe rolin e dhëmbëve në të ushqyer.</li> </ul>	
<b>II. Lënda dhe energjia</b>	<b>II.1 Lënda dhe vetitë e saj</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Klasifikimi i lëndëve</b> (Lëndët ose artikujt e përditshëm me të cilët jeton dhe punon nxënësi)</li> <li>• <b>Toka burim jete dhe i të mirave materiale</b> (Toka burim i të gjitha të mirave materiale jetësore)</li> </ul>	<p><b>Nxënësi do të jetë në gjendje:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të dallojë ndryshimet dhe ngjashmëritë ndërmjet lëndëve, me anë të shqisave.</li> <li>- Të emërtojë llojet e ndryshme të lëndëve , siç janë: uji, qelqi, druri, metali, plastmasat, letra, sheqeri, vaji etj.</li> <li>- Të tregojë lëndët që nxirren nga toka, siç janë: ushqimet, lëndët e djegshme, mineralet, druri, shkëmbinjtë, uji etj., që përdoren në jetën e përditshme.</li> </ul>	<p>Punëdore (punimi i modeleve nga letra dhe kartoni, lëndët ushqyese, rreziqet nga lëndë të ndryshme, zjarri, rryma elektrike, ndotja e ambientit etj.). Arti figurativ (dallimi i ngjyrave, i modeleve etj.).</p>



		<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Uji</b> (Përhapja në natyrë, vetitë dhe përdorimi në jetë)</li> <li>• <b>Ajri</b> (Përhapja, vetitë dhe funksioni i tij për jetë)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të përshkruajë ujin si lëndë e domosdoshme në natyrë, teknologji dhe jetë.</li> <li>- Të shpjegojë vetitë e ujit, qarkullimin në natyrë (avullimi, kondensimi, ngrirja, të reshurat).</li> <li>- Të përcaktojë temperaturën, vëllimin dhe masën e lëndëve të ndryshme.</li> <li>- Të vlerësojë rolin dhe qëndrimin e njeriut për ruajtjen e ujit dhe të mjedisit nga ndotësit.</li> <li>- Të përshkruajë ajrin si lëndë e gaztë që na rrethon dhe që nuk e shohim, por në forma të ndryshme e hetojmë praninë e tij (procesi i frymëmarrjes, procesi i djegies, kundërmimi, lëvizja e erës etj.).</li> <li>- Të përshkruajë vetitë e ajrit.</li> <li>- Të vlerësojë rëndësinë e ajrit për jetë (procesin e frymëmarrjes, procesin e djegies, procesin e zhvillimit të bimëve dhe në industri).</li> </ul>	Mjekësia dhe shëndetësia (mirëmbajtja e higjienës personale, mënyra e përdorimit, e ruajtjes, afati i përdorimit të barnave etj.).
<b>II. Lënda dhe energjia</b>	<b>II. 2. Shndërrimet e lëndëve</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Lëndët ushqyese dhe higjienike</b> (Lëndët ose artikujt e përdit-</li> </ul>	<p><i>Nxënësi do të jetë në gjendje:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të përshkruajë lëndët kryesore të ushqimit (buka, drithërat, mishi,</li> </ul>	

		<p>shëm ushqimorë dhe higjienikë. Masat për ruajtjen dhe përdorimin e lëndëve ushqimor dhe higjienike)</p> <p>• <b>Energjia dhe burimet e saj</b> (Burimet kryesore të energjisë, llojet dhe format e saj).</p>	<p>peshku, prodhimet e qumështit, sheqeri, mjalti, gjalpa, vaji, pemët, perimet vitaminat dhe kripa e gjellës).</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të dallojë lëndët ushqyese me prejardhje bimore dhe shtazore.</li> <li>- Të identifikojë lëndët ushqimore natyrore dhe ato të përpunuara (artificiale).</li> <li>- Të dallojë lëndët ushqimore nga ato higjienike.</li> <li>- Të arsyetojë rëndësinë e lëndëve higjienike për ruajtjen e shëndetit.</li> <li>- Të vlerësojë ndikimin e dëmshëm të lëndëve helmuese (acidet, mjetet për zbardhje dhe dezinfektim “varikinet”, detergjentet, pesticidet), të djegshme (alkoolet, nafta, benzina, gazi propan- butan) dhe pëlcitëset (fishekzjarret).</li> <li>- Të shfrytëzojnë recetat për përdorimin e lëndëve higjienike, të cilat janë të shënuara në paketim të tyre.</li> </ul> <p>- Të përshkruajë burimet kryesore të energjisë, duke filluar nga ushqimi (për organizëm), diellore, lëndët e</p>	
--	--	---	--	--

			<p>djegshme, qymyri, nafta, gazi natyror, druri, uji, era, etj. dhe rëndësia e tyre për jetë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të përshkruajë format e energjisë (nxehhtësi, dritë, etj).</li> <li>- të përgatisin çaj, kafe, pije freskuese, akullore etj.</li> </ul>	
<b>III. Proceset fizike</b>	<b>III.1. Forca dhe lëvizja</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Trupat në natyrë dallohen sipas vetive të ndryshme (ngjyrë formë, peshë, madhësi dhe temperaturë dhe përbërje).</li> <li>• Trupat në natyrë ose qëndrojnë në qetësi ose lëvizin.</li> <li>• Trupat e ndryshëm kryejnë lloje të ndryshme të lëvizjeve.</li> <li>• Makinat e thjeshta shërbejnë për të kryer punë më lehtë.</li> <li>• Trupat vendosen në baraspeshim në mënyra të ndryshme (kandari, peshorja, luhatja në traverzë).</li> <li>• Burime të zërit janë të gjithë trupat të cilët mund të</li> </ul>	<p><b>Nxënësi duhet të jetë në gjendje:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të dallojë trupat për nga ngjyra, forma, përbërja (të ngurtë, të lëngët, të gaztë, elastik), për nga pesha, madhësia (vëllimi) dhe temperatura.</li> <li>- Të tregojë trupin në prehje dhe në lëvizje.</li> <li>- Të përshkruajë zhvendosjet e trupave nga një pozitë në tjetrën si rezultat i veprimit të forcave në ta: të duarve, të motorit, duke i shtyrë, tërhequr, apo duke ua larguar bazën kur bienë lirisht dhe të gjejë shembuj për lloje të ndryshme të lëvizjeve.</li> <li>- Të identifikojë gjashtë lloje të makinave të thjeshta: llozin, vidën, çekrikun, rrotën dhe boshtin, rrafshin e pjerrët dhe pykën dhe të gjejë shembuj të makinave të thjeshta që</li> </ul>	<p>Arti figurativ për njohjen e ngjyrave, punëdore për njohje të formës, madhësisë, peshës dhe vëllimit të trupave.</p> <p>Muzikë për njohjen e instrumenteve muzikore me tela.</p>

		lëkunden (dridhen)	<p>mund t'i gjejë në shkollë dhe në shtëpi.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të tregojë shembuj të baraspeshimit të trupave duke u bazuar në lojërat e përditshme në shkollë dhe në shtëpi.</li> <li>- Të shpjegojë zërin si lëvizje lëkundëse të trupave: dridhje të telave të kitarës, çiftelisë, shiritit të lastikut, daulles, daires, pianos dhe veglave të tjera muzikore, pirunit akustik etj. dhe përhapjes së tij në ajër, ujë dhe metale.</li> </ul>	
<b>III. Proceset Fizike</b>	<b>III. 2. Elektriciteti, magnetizmi dhe drita.</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Magnetet bashkëveprojnë mes vete me pole të veta pa u takuar fare.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të demonstrojë tërheqjen dhe shtyerjen e poleve të njëjta magnetike pa u takuar fare, orientimin e gjilpërës magnetike në drejtim veri- jug dhe të gjejë shembuj të bashkëveprimit dhe të zbatimit të magnetëve në jetën e përditshme.</li> </ul>	Punëdore, për gjetjen e mbajtëseve në të cilat duhet të varen magnetet me fije najloni me qëllim të demonstrimit të bashkëveprimit të tyre.
<b>IV. Toka dhe hapësira</b>	<b>IV.1 Rrethina ime</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Njeriu dhe rrethina</li> <li>• Orientimi në natyrë (Skica, harta, globi)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të identifikojë objektet kryesore në rrethinë (mal, kodër, fushë, lumë, liqe etj.).</li> <li>- Të përshkruajë veçoritë fizike të objekteve natyrore (formën, lartësinë,</li> </ul>	

			<p>largësinë dhe madhësinë).</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të vlerësojë se ajri, uji, toka dhe bota e gjallë janë qenësore për rrethinën.</li> <li>- Të dallojë anët kryesore të botës (veri, jug, lindje dhe perëndim).</li> <li>- Të përshkruajë vendosjen e objekteve në natyrë.</li> <li>- Të tregojë se objektet, pjesët e sipërfaqes dhe tërë Toka mund të paraqiten në letër, glob të zvogëluara dhe me shenja të veçanta</li> </ul>	
<b>IV. Toka dhe hapësira</b>	<b>IV.2. Toka, sistemi diellor dhe gjithësia</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Dita, nata dhe stinët e vitit</li> <li>• Kosova – Vendi im</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të përshkruajë vetitë e Tokës, Diellit dhe Hënës.</li> <li>- Të tregojë se Dielli është burim i dritës, nxehtësisë dhe jetës në Tokë.</li> <li>- Të përshkruajë arsyet e ndërrimeve të ditë-natës, stinëve të vitit dhe ndryshimet e motit.</li> <li>- Të matë me termometër temperaturën e ajrit.</li> <li>- Të tregojë pozitën e Kosovës në hartë dhe fqinjët e saj.</li> <li>- Të përshkruajë veçoritë elementare natyrore (relievin, ujin, ndryshimet e motit, botën bimore dhe shtazore) në Kosovë.</li> </ul>	

## UDHËZIME METODOLOGJIKE

Për realizimin me sukses të planit dhe programit të lëndës Njeriu dhe natyra është e domosdoshme të zbatohen metoda, teknika e forma të shumëllojta të punës dhe një kompleks i tërë procedurash (informacion i ri, përsëritje, përforsim, ushtrime, detyra, punë me projekte, punë praktike, mjete materiale teknike, siç janë: vizatime, peizazhe, diagrame, modele, grafikone, kimikate, enë kuzhine, enë laboratorike, instrumente dhe mjete të tjera teknike bashkëkore – kompjuter, internet etj.).

Përzgjedhja e metodave është kompetencë e mësimitdhënësit të lëndës. Ajo bëhet në përshtatje me nevojat dhe kërkesat e nxënësve, me natyrën e përmbajtjes së temës mësimore, me bazën didaktike, me nivelin e formimit të nxënësve etj.

Metodat dhe teknikat e punës me nxënës duhet të jenë të kombinuara dhe të shumëllojta, ngase nxësin dinamikën e orës mësimore, thyejnë monotoninë dhe motivojnë nxënësit për mësim.

Metodat, teknikat dhe format e punës me nxënës janë po aq të shumëllojta sa edhe llojet e mësimnxënies. Ato duhet të jenë në funksion të përvetësimit më të lehtë të përmbajtjeve mësimore dhe zbatimit më të shpejtë e më të saktë të njohurive, shprehive, shkathësive, qëndrimeve dhe vlerave të tjera, participojnë në tërësinë e formimit të personalitetit për t'u përballur me sfidat jetësore.

Duke synuar përmbushjen e kërkesave për nxënie cilësore, sugjerohen disa metoda, forma dhe teknika të ndryshme të punës:

- Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (shpjegimi, sqarimi, ushtrimet praktike dhe shembujt);
- Mësimdhënie joedrejtëpërdrejtë (shqyrtimi, zbulimi, zgjidhja e problemeve);
- Mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve);
- Diskutimi dhe të nxënit në bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit);
- Mësimdhënie përmes të menduarit (të menduarit kritik, krijues, zgjidhjes së problemeve me kompjuter);
- Të mësuarit përmes projekteve, punëve kërkimore në terren;
- Mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit dhe eksperimentit;
- Të mësuarit dhe të nxënit përmes mjeteve multimediale e në veçanti përmes kompjuterit;

- Vetëhulumtimi;
- Të mësuarit në natyrë dhe vizitave në objekte industriale.

Në të gjitha rastet zbatimi i metodave apo i teknikave mësimore duhet të shoqërohet me përdorimin e materialeve dhe të mjeteve përkatëse didaktike, pa të cilat nuk mund të arrihen rezultatet e pritura.

## **VLERËSIMI**

Vlerësimi është veprimtari dhe instrument që përdoret për të matur punën dhe arritjet e nxënësve. Ai luan rolin e një aparati matës që bën të qartë situatën në të cilën ndodhet nxënësi, stafi arsimor, shkolla dhe komuniteti i saj. Vlerësimi i një sistemi të gjerë që mbështetet në procesin e të nxënësve përfshin këto forma të vlerësimit:

- formues
- diagnostikues
- përmbledhës dhe
- motivues

Vlerësimi i vazhdueshëm pas çdo teme mësimore jep rezultate më të mira. Ai nuk mat vetëm njohuritë e fituara, por edhe vlerëson shkallën në të cilën ka arritur një veprim edukativ, i cili lë gjurmë në personalitetin e nxënësit. Vlerësimi përfundimtar përfshin aktivitetin e përgjithshëm të të nxënësve (përgjigjet me gojë, sjelljet në grup, aftësitë që i fitojnë gjatë punës eksperimentale, detyrat e shtëpisë, rezultatet e testeve dhe të punimeve me shkrim etj.).

Vlerësimi i nxënësve përfshin tri fusha kryesore:

- aftësitë njohëse (kognitive);
- aftësitë emocionale (afektive) dhe
- aftësitë psikomotorike.

Mësimdhënësi përzgjedh dhe përdor mjete e teknika të shumëllojta të vlerësimit dhe pas zhvillimit të përmbajtjeve të programit, nxënësit vlerësohen me nota (për një temë, për një tërësi temash, për një gjysmëvjetor dhe në fund të vitit shkollor). Vlerësimi duhet të jetë transparent ndaj nxënësve, prindërve, administratorëve të arsimit dhe komunitetit.

Përfundimet e vlerësimit i shërbejnë mësimdhënësit për arritjen e qëllimeve të ndryshme:

1. Të sigurojë informacione rreth përparimit të nxënësve;
2. T'u sigurojë nxënësve informacion mësimor;
3. Për motivimin e nxënësve;
4. Të shënojë përparimin e nxënësve;
5. Të sigurojë realizimin e objektivave aktualë;
6. Të vlerësojë gatishmërinë e nxënësve për nxënie në të ardhmen;
7. Të reflektonë për përmirësimin e mësimdhënies bazuar në vlerësimin e të tjerëve dhe në vetëvlerësim.

## **BURIMET DHE MJETET MËSIMORE**

Që të realizohet me sukses mësimdhënia dhe mësimnxënia e planit dhe e programit të kimisë, mësimdhënësit dhe nxënësit duhet të shfrytëzojnë burime dhe mjete të ndryshme të informimit:

- 1) Literaturë për lëndën Njeriu dhe natyra në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaja botërore.
- 2) Revista profesionale dhe shkencore, fjalorë, enciklopedi.
- 3) Fotografji, atlasë, modele, skema, diagrame, makete, harta, globe etj.
- 4) Pajisje multimediale (programe të kompjuterëve, interneti, CD).
- 5) Aparat TV me videorekorder, grafoskop, fotoslajde, videokaseta që përmbajnë materiale të ndryshme shkencore me interes për nxënësit.
- 6) Literaturë tjetër e nevojshme që ekziston në biblioteka dhe mjetet e tjera që gjenden në treg.

Është kompetencë dhe liri e mësimdhënësit që, varësisht nga kushtet në të cilat punon shkolla, të zgjedhë burimin e informacionit dhe mjetet ndihmëse mësimore, duke i kushtuar vëmendje baraspeshës së të dhënave eksperimentale, gojore, vizuele, me theks të veçantë në atë që është qenësore për të mësuar. Kjo përzgjedhje gjithnjë duhet të bëhet duke e ruajtur dhe duke e ngritur nivelin e cilësisë së mësimdhënies dhe të mësimnxënies.

Kjo liri e të zgjedhurit të burimeve mësimore duhet t'i takojë edhe nxënësit.



## **HYRJE**

Edukta qytetare synon të përgatisë nxënësit qytetarë të ardhshëm aktivë. Lënda e edukatës qytetare u ndihmon nxënësve të vetëdijësohen për identitetin dhe sigurinë e tyre personale, të mësojnë të komunikojnë, të respektojnë besimet dhe vlerat kulturore në një shoqëri shumetnike, të kuptojnë mirë të drejtat dhe përgjegjësitë e individëve në familje, shkollë dhe komunitet, si dhe të njihen me natyrën e funksionimit të demokracisë. Kjo lëndë përpiqet të edukojë një qytetar të pajisur me shprehitë dhe të kuptuarit e proceseve të cilat i aftësojnë ata të shohin, të gjykojnë, të vendosin dhe të veprojnë drejt.

## **QËLLIMET**

Qëllimet dhe parimet e përgjithshme të edukatës qytetare janë në harmoni me qëllimet e përgjithshme të arsimit të detyruar. Në veçanti, qëllimet që ky program ka lidhen me zhvillimin personal dhe social, kontributin në zhvillimin moral të nxënësve dhe përgatitjen për t'i bërë ata qytetarë të përgjegjshëm. Në këtë këndvështrim, lënda Edukatë qytetare synon:

- të krijojë kushte që nxënësi të përfitojë njohuri të nevojshme për demokracinë dhe qytetarinë;
- të mundësojë krijimin e qendrimeve dhe vlerave, mësimin e strategjive efektive të zgjidhjes së problemeve, pranimin kritik të informacionit dhe mjeteve të komunikimit;
- të kontribuojë në zhvillimin e vetëdijës së nxënësit se dukuritë janë të lidhura me njëra-tjetrën në mënyrë të kushtëzuar dhe se janë në ndërveprim reciprok;

- t'i zhvillojë njohuritë dhe aftësitë intelektuale të nxënësit, të domosdoshme për të kuptuar, analizuar dhe vepruar në jetën e përditshme;

## **OBJEKTIVAT**

Nxënësi:

### **Të njohë**

- tiparet e tij kryesore që e dallojnë atë nga të tjerët;
- tiparet e njerëzve që përbëjnë botën në të cilën ai jeton;
- rregulla të caktuara në veprimtari të ndryshme që zhvillohen në: familje, klasë, shkollë, lojë etj;
- mjetet kryesore të komunikimit: telefon, letër, telegram, internet etj.

### **Të kuptojë**

- ku dallon dhe çfarë ka të ngjashme me anëtarët e familjes, me shokët e klasës etj.
- rëndësinë e vendosjes së rregullave në një veprimtari të caktuar
- rëndësinë e komunikimit me letra, mesazhe etj.

### **Të vlerësojë**

- disa nga nevojat dhe dëshirat bazë të tij dhe të shokëve, duke bërë dallimin ndërmjet tyre;
- të drejtat dhe detyrat e pjesëtarëve të familjes;
- rolin e tij dhe të të tjerëve në familje, klasë, grup dhe komunitet;
- nevojën që ai ka për njerëzit dhe mjedisin që e rrethon;
- kulturën, vlerat dhe besimet në një shoqëri shumetnike.

### **Të zbatojë**

- në praktikë, në situata të simuluar, sjellje të sigurt kur ecën në komunikacion;
- të përdorë fjalorin e duhur në një situatë të caktuar rrugore;
- gatishmërinë e tij për të ndjekur rregullat në veprimtari të përditshme në familje, grup, klasë, shkollë dhe komunitet;

- aftësi praktike në përdorimin e telefonit dhe shkrimin e një kartoline.

#### **Të analizojë**

- ndarjen e detyrave në familjen e tij,
- rregulla të thjeshta, në bashkëpunim me të tjerët, në veprimtaritë e tij të përditshme,
- njerëzit që kanë vështirësi për të kuptuar dhe bërë gjëra të ndryshme dhe të tregojë gatishmërinë për t'i ndihmuar ata etj.,

#### **Të sintetizojë**

- aspekte të ndryshme të jetës në familjen e tij me atë të familjeve të tjera (ushqimin, orënditë, organizimi i kohës së lirë);
- rëndësinë e punës së përbashkët për plotësimin e nevojave dhe dëshirave të individëve dhe të grupeve ku ata bëjnë pjesë.

#### **Të zhvillojë qëndrime dhe vlera**

- se diversiteti kulturor, fetar dhe gjuhësor është begati e një shoqërie demokratike,
- përmes shfaqjes së qëndrimit kritik ndaj mënyrës së komunikimit me të tjerët në shtëpi, shkollë dhe komunitet,
- duke qenë tolerant ndaj anëtarëve të komunitetit ku jeton,

### **STRUKTURA E PROGRAMIT**

<b>Kategoritë</b>	<b>Nënkategoritë</b>	<b>Numri i orëve</b>
ZHVILLIMI INDIVIDUAL DHE IDENTITETI	Identiteti, rritja dhe ndryshimi Siguria dhe mbrojtja	9
GRUPET DHE INSTITUCIONET	Familja Shkolla	12
KULTURA	Gjuha dhe komunikimi Vlerat kulturore dhe besimet	9
KOHA DHE NDRYSHIMET	Koha dhe njeriu	7

## ZHVILLIMI INDIVIDUAL DHE IDENTITETI

### **Identiteti, rritja dhe ndryshimi. Siguria dhe mbrojtja**

Nxënësi të përvetësojë përmbajtjen e koncepteve themelore për identitetin personal (unin e tij), rritjen, tiparet e tij personale, të drejtat dhe përgjegjësitë e tij, nevojat, dëshirat, besimin, vetëbesimin, vendim-marrjen etj.

Të zotërojë përmbajtjen e koncepteve si: siguri, siguri personale, mbrojtje, mbrojtje personale, rrezik, situatë e rrezikshme, situatë e rrezikshme në rrugë, mbrojtje nga uji, zjarri, rryma elektrike, kujdes, sjellje, rregull e sjelljes në rrugë, në trafik, në shkollë, në park, në shitore, në lojë etj.

### **Rezultatet e pritshme**

Nxënësi:

- ✓ radhitë disa nga tiparet që e karakterizojnë atë;
- ✓ vendos veten në një mjedis të caktuar (familje, klasë, lagje etj.) dhe të shohë veten si pjesë e tij;
- ✓ shpreh nevojat dhe dëshirat e tij;
- ✓ shpjegon ku dallon dhe çfarë ka të ngjashme me shokët e klasës, me anëtarët e familjes (gjyshërit, prindërit, vëllezërit, motrat etj.);
- ✓ kupton se plotësimi i nevojave, si: ushqimi, veshja, banesa, lojërat, mësimi etj., përbën një të drejtë elementare që i takon si atij, edhe të tjerëve;
- ✓ flet për rëndësinë e respektimit të rregullave të qarkullimit rrugor;
- ✓ identifikon disa nga rregullat e sjelljes së tij në shtëpi, në rrugë, në park, në lagje, në lojë etj.;
- ✓ dallon disa nga shenjat e rëndomta të trafikut që ai sheh ose ka parë dhe të tregojë nëse ato gjenden në rrugën e makinës ose të këmbësorit;
- ✓ përmend personat që mund ta ndihmojnë, të kalojë rrugën dhe të përshkruajë rolet e tyre;
- ✓ dallon se disa nga mjediset e lojës janë më të sigurta se të tjerat;
- ✓ të dijë dhe të respektojë rregullat e përdorimit të ujit, zjarrit, rrymës elektrike në shtëpi, në shkollë dhe gjetkë.

## GRUPET DHE INSTITUCIONET

### **Familja. Shkolla**

Nxënësi duhet të përvetësojë përmbajtjen e koncepteve bazë të këtyre dy nënkategorive, si: familje, shkollë, rol shoqëror, shtëpi-banesë; të kuptojë rolin, detyrat, të drejtat dhe obligimet e familjes dhe shkollës; të njohë trungun familjar, ndarjen e punëve në familje, rregullat në shkollë dhe familje, buxheti familjar, festat familjare, punë e përbashkët, punë në shtëpi, punë në klasë, punë në komunitet.

#### **Rezultatet e pritshme:**

Nxënësi:

- ✓ diskuton për ndryshimet në familje, në klasë apo në shkollë;
- ✓ përshkruan trungun e tij familjar (brezat në familje);
- ✓ përshkruan banesën ku jeton duke e krahasuar me banesat e shokëve apo të të afërmëve të tij.;
- ✓ vlerëson të drejtat dhe detyrat e pjesëtarëve të familjes;
- ✓ krahason aspekte të ndryshme të jetës në familjen e tij me atë të familjeve të tjera (ushqimi, orëditë, organizimi i kohës së lirë);
- ✓ përshkruan disa nga festat familjare, festat lokale dhe kombëtare;
- ✓ dallon rolet e veçanta që çdo individ ka në shoqëri (në: familje, klasë, grup, lagje etj.);
- ✓ të dijë rëndësinë e bashkëveprimit me të tjerët në familje, në klasë, në grup, në lagje etj., për të zgjidhur probleme të ndryshme;
- ✓ demonstroi dëshirë dhe shkathhtësi për respektimin e rendit shtëpiak në shkollë;
- ✓ përshkruan shembuj nga jeta shkollëse se si shkolla është e hapur për të gjithë që e dëshirojnë atë.

## KULTURA

### **Gjuha dhe komunikimi. Vlerat kulturore dhe besimet**

Nxënësi të përvetësojë përmbajtje programore lidhur me komunikimin, format e komunikimit, mjetet e komunikimit si: letrat, mesazhet, telefoni, shtypi, televizioni, **interneti** etj.

Të zotërojë konceptet themelore për vlerat kulturore dhe besimet, diversitetet etnike, gjuhësore, fetare dhe gjinore si begati e shoqërisë, dashurinë, tolerancën dhe ndihmën e ndërsjellë ndërmjet njerëzve etj.

### **Rezultatet e pritshme**

Nxënësi:

- ✓ përshkruan mjetet kryesore të komunikimit: telefon, letër, telegram; **internet**;
- ✓ vlerëson marrjen e informacionit për ngjarje të ndryshme nga radio, televizioni, kompjuteri (interneti) dhe gazetat;
- ✓ dëshmon konkerisht mirësjellje gjatë komunikimit;
- ✓ shpreh gatishmërinë për t'i ndihmuar ata që kanë vështirësi për të komunikuar;
- ✓ vlerëson nevojën që ai ka për njerëzit dhe mjedisin që e rrethon;
- ✓ shpjegon rëndësinë e tolerancës, dashurisë dhe mirëkuptimit ndërmjet njerëzve;
- ✓ organizon festat, duke dhënë kontribut vetjak në punën e përbashkët në ditëlindjet (e shokut, shoqes), ditën e shkollës e festa të tjera.

## **KOHA DHE NDRYSHIMET**

### **Koha dhe njeriu**

Në nënkategorinë Koha dhe njeriu nxënësi duhet të zotërojë konceptet themelore si: zhvillimi, ndryshimet, teknologjia; koha: e kaluara, e sotmja dhe e ardhmja; burimet natyrore, mjedise gjeografike, mjetet e punës, etj.

### **Rezultatet e pritshme**

Nxënësi:

- dallon konceptet kohore si: e shkuar, e tashme dhe e ardhme;
- krahason jetesën, banesën, veshjen, ushqimin, komunikacionin sot me atë të gjyshërve të tij (përmes fotove, tregimeve);

- jep shembuj që tregojnë për mënyrën e ndryshimit të jetesës në komunitetin e tij;
- identifikon njerëzit më të shquar të komunitetit ku jeton, të cilët kanë ndihmuar në zhvillimin e vendit;
- përdorë burime të ndryshme për të kuptuar dhe rindërtuar të kaluarën, si letra, ditarë, intervista, libra, fotografi, etj.;
- përshkruan sesi njerëzit kanë krijuar vendet e tyre të banimit dhe si e kanë ndryshuar jetën e tyre.

## LIDHJE NDËRLËNDORE

Edukata qytetare, si pjesë e grupit të lëndëve shoqërore, përveç se është në veten e saj multidisiplinare, gërshetohet edhe me programet dhe përmbajtjet e lëndëve të tjera shoqërore si histori dhe gjeografi, gjuhë dhe komunikim, por dhe me matematikën, fizikën, artet, edukimin fizik, etj.

**Gjuha dhe komunikimi:** Esetë dhe shkrimet për temat e qytetarisë si p.sh., “Kush jam unë?”, apo dhe përdorimi i gazetave, revistave, pjesëve letrare dhe shkrimeve të tjera që trajtojnë ngjarje dhe episode nga jeta e përditshme janë një urë lidhëse e trajtimit të temave të qytetarisë me fushën e gjuhës dhe të komunikimit. Gjuha amtare dhe e huaj shërbejnë mjaft për të dhënë tablonë e plotë të qytetarisë globale.

**Artet:** Përgatitja e materialeve ilustruese si posterë, albume, si dhe efekte të tjera vizuale për një vetëdijësim qytetar demokratik në funksion të pjesëmarrjes aktive dhe qytetarisë sa më të mirë është një mundësi e vazhdueshme e lëndës së Edukatës qytetare me artet figurative. Kjo ndërlidhje mund të përdoret në tema si nevojat dhe të drejtat e njeriut, rregullat e klasës, shtëpisë dhe komunitetit, etj. Edukimi artistik përmes këngëve, valleve popullore dhe atyre të huaja, po ashtu rrit peshën e ndërveprimit të edukatës qytetare me muzikën.

**Matematikë:** Përdorimi i numrave lidhur me tema aktuale të edukatës qytetare, interpretimi i të dhënave që lidhen me zgjidhjen e problemeve sociale brenda grupit, krijojnë po ashtu mundësi për qasje ndërlëndore.

**Edukim fizik:** Zhvillimi i veprimtarive të ndryshme sportive që lidhen me përkujtimin e datave të ngjarjeve dhe personave që kanë kontribuar në krijimin e vizionit të qytetarit në botë apo në vend, po ashtu janë një mundësi pozitive që favorizon lidhjen ndërlëndore.

## UDHEZIME METODIKE

Me qëllim të realizimit të programit mësimor në këtë lëndë mund të organizohen takime me njerëz, mund të shfrytëzohen burime të ndryshme dhe të simulohen raste për zgjidhje:

- Takime me njerëz të ndryshëm të komunitetit (vëzhgime, intervista, anketime, bashkëbisedime, konsulta me ekspertë etj.),
- Përdorimi i publikimeve të ndryshme (gazeta, buletine informacione, tekste, videokaseta, dramatizime, posterë etj.),
- Simulime (lojërat me role, simulimi i diskutimeve ose i situatave nga fusha të ndryshme të veprimtarive publike etj.).

Përveç metodave tradicionale, në lëndën e Edukatës qytetare në shumë raste mund të zbatohet **loja me role**. Për zbatimin e kësaj forme të punës është e domosdoshme të bëhet **simulimi** i një ngjarjeje. Nxënësit marrin role, p.sh., të mësuesit, drejtorit të shkollës, prindërve, policit të qarkullimit rrugor, anëtarëve të ndryshëm të komunitetit, etj. Mësuesi në këtë rast luan rolin e koordinatorit, ndërsa të gjithë nxënësit e klasës marrin pjesë aktive në këtë proces. Ata mund të ndahen sërish në grupe p.sh., grupi i punëtorëve që mbrojnë natyrën dhe parqet, grupi i fëmijëve që nuk respektojnë rregullat e caktuara për mjediset publike, etj. Gjatë një ore mësimi mund të debatohet rreth asaj se si është çështja, cilat janë rrugëzgjidhjet e problemit për të cilin debatohet, etj.

Theks i veçantë në metodologjinë e punës duhet t'u kushtohet metodave aktive të punës, si: Puna me projekte, mësimi problemor, mësimi me bashkëpunim, biseda, vëzhgime, puna në mjedise konkrete (me organizata të ndryshme të komunitetit) etj.

Si forma të punës, mësimdhënësve u sugjerohet të organizojnë punën në klasë me çifte dhe grupe. Ndarja e nxënësve në çifte dhe grupe, u jep atyre mundësi për pjesëmarrje dhe bashkëpunim. Me këtë rast nxënësve të ndarë në çifte dhe grupe u jepen 5 minuta kohë për të vendosur p.sh., Cili është roli i babait dhe i nënës në familje? Kjo mund të arrihet përpara se të nisë diskutimi i gjithë klasës. Nxënësve duhet t'u tregohet koha për të cilën do të zgjidhet problemi. Ata ndahen në grupe apo çifte, ndërsa mësuesi luan rolin e mbikëqyrësit, dhe sipas nevojës edhe jep udhëzime apo sqarime. Në përfundim të orës mësimore, çiftet apo grupet raportojnë para gjithë nxënësve të klasës. Secili grup duhet ta këtë përfaqësuesin i cili raporton para klasës.



## **UDHËZIME PËR VLERËSIM**

Vlerësimi i nxënësve në lëndën e Edukatës qytetare duhet të jetë i përhershëm. Ky vlerësim ka qëllime të shumëfishta. Kështu përmes vlerësimit:

- sigurohen informacione për përparimin e nxënësit;
- nxënësit aftësohen të krahasojnë arritjet e tyre me rezultatet e pritshme. Në këtë mënyrë nxënësi do të bëjë edhe vetëvlerësimin e asaj që ka arritur të zotërojë;
- sigurohet motivimi i nxënësve për punë të mëtejshme;
- sigurohet edhe realizimi i objektivave.

### **Llojet e vlerësimit**

Në të gjitha lëndët mësimore ekzistojnë lloje të ndryshme vlerësimi. Në lëndën e Edukatës qytetare mund të zbatohen disa lloje vlerësimi. Secili prej tyre ka qëllime të caktuara.

Vlerësimi duhet të jetë i përhershëm, duke filluar që nga orët e mësimin, veprimtaritë praktike e deri te vlerësimi përmes testeve zyrtare. Në klasë, gjatë orës së mësimin mund të bëhen këto vlerësime:

- vlerësimi i rëndomtë gjatë pjesëve të ndryshme të orës;
- vlerësimi i detyrave të shtëpisë;
- vlerësimi i projekteve të realizuara individualisht ose në grup;
- vlerësimi me testeve të hartuara nga vetë mësuesi.

Kriteret për vlerësimin e nxënësve janë përcaktuar qartë në Udhëzimin Administrativ për vlerësimin e shkallës së arritshmërisë së nxënësve.

## **LITERATURA**

### **Literatura për përmbajtje**

1. Grup autorësh, Edukata shoqërore, kl.I,II,III,IV, botime të Librit Shkollor, Prishtinë, 2002,2003,2004

2. Grup autorësh, Edukata qytetare, kl.V,VI,VII,VIII, botime të Librit Shkollor, Prishtinë, 2002,2003,2004
3. Shemsi Krasniqi, Edukatë qytetare, kl.VI, botues “Dukagjini”, 2004
4. E.Mato, B.Shatri, Edukatë qytetare, kl.VI, botues Libri Shkollor, 2004
5. E.Mato, B.Shatri, Edukatë qytetare, kl.VII, botues Libri Shkollor, 2004
6. E.Mato, B.Shatri, Edukatë qytetare, kl.X, botues Libri Shkollor, 2004
7. D.Hoti, N.Zabeli, Edukatë qytetare, kl.XI, botues Libri Shkollor, 2005
8. Grup autorësh, Standardet e arritjes së lëndës së edukimit qytetar, Tiranë, 2003
9. Grup autorësh, Qytetaria 1, Tiranë, 2000
10. Xhemajli Beluli, Kultura qytetare, Shkup, 2002

### **Literatura për metodologji të mësimdhënies**

1. Bardhyl Musai, Psikologjia e edukimit, Tiranë, 2002
2. Bardhyl Musai, Metodologjia e mësimdhënies, Tiranë, 2003
3. Grup autorësh, Qeverisja dhe udhëheqja në arsim, KEC-i, Prishtinë, 2003
4. Grup autorësh, Edukimi ndërkulturor dhe i të drejtave të njeriut në shkollë, Tiranë, 2003
5. Bonnie Miller, Si të krijohet kontakti i suksesshëm me nxënësit, QPEA, 2003
6. Bonnie Miller, Komunikimi me fëmijë, Doracakë për prindër e arsimtarë, QPEA, 2003
7. Osman Buleshkaj-Robert C. Mizzi, Mesazhe nga klasa, KEDP, Prishtinë, 2003

## HYRJE

Muzika është pjesë e formimit kulturor dhe nevojë e përhershme e njeriut. Ajo komunikon në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe kreative me tërë qenien e tij, duke ia formuar mjedisin tingëllor. Nisur nga roli i muzikës në jetën e njeriut dhe ndikimit që ka në të, del dhe rëndësia e formimit edukativ-muzikor.

### **Edukata muzikore bën të mundshme:**

- dëgjim selektiv dhe aktiv të muzikës në programet e mediave dhe shfaqjeve muzikore;
- pjesëmarrje në formacione korale - instrumentale dhe në veprimtari të tjera muzikore;
- arsimim të mëtejshëm i cili nxit interesim më të gjerë për muzikën, përkatësisht përgatitjen për ndonjë profesion ku muzika është pjesë përbërëse.

## QËLLIMET

Lënda ka për qëllim:

- **Të sjellë gëzim, emocione dhe të zgjojë interes për veprimtari të ndryshme muzikore;**
- **Të zhvillojë dhe të ngrisë muzikalitetin në vazhdimësi;**
- **Të ndikojë në formimin e qëndrimit pozitiv ndaj muzikës kombëtare dhe botërore;**
- **Të edukojë për mjedis të shëndoshë tingëllor;**
- **Të zhvillojë kriteret për vlerësim dhe mendim kritik;**

## OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM DHE SPECIFIKË

Nxënësit do të:

- ***muzikojnë në mënyrë të përbashkët dhe individuale:***
  - këndojnë këngë popullore dhe artistike shqiptare dhe të popujve të tjerë, sipas imitimit (veshit) dhe simboleve grafike, pa dhe me shoqërim instrumental;
  - luajnë në vegla muzikore ritmike dhe melodike (popullore dhe të ORF-it), sipas imitimit dhe simboleve grafike;
  - zhvillojnë kulturën vokale (qëndrimi, frymëmarrja, artikulimi, këndimi i bukur dhe shprehjeplotë, gradacionet në temp dhe në dinamikë);
  - përmes ligjërimeve dhe lëvizjes zhvillojnë ndjenjën ritmike.
- ***zhvillojnë aftësinë për dëgjim aktiv përjetues dhe analitik të muzikës:***
  - vërejnë dhe dallojnë karakterin shprehës , mjetet dhe formacionet interpretuese në veprat muzikore të dëgjuara;
  - dallojnë llojet (gjinitë) dhe zhanret e ndryshme muzikore përmes dëgjimit dhe interpretimit;
  - dallojnë cilësitë e tingullit muzikor , lëvizjet e melodive, gradacionet në temp dhe ngjyrimet dinamike gjatë këndimit dhe veprimtarive të tjera muzikore;
- ***zhvillojnë të shprehurit kreativ:***
  - nxiten për shprehje të përjetimeve dhe përfytyrimeve muzikore përmes lëvizjes, vallëzimit, shprehjes figurative dhe gjuhësore sipas prirjeve individuale;
  - nxiten për shprehje kreative ritmike dhe melodike në bazë të imagjinimeve tingëllore individuale

<i>Prej lojës dhe përjetimi muzikor kah njohja e vetëdijshme</i>	<i>PËRMBAJTJET TEMATIKO INFORMATIVE</i>	<i>SHEMBUJT</i>
<p><b>I</b> <b>N</b> <b>T</b> <b>E</b> <b>R</b> <b>P</b> <b>R</b> <b>E</b> <b>T</b> <b>I</b> <b>M</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Përmes instrumenteve ose me zë shoqërojnë në ostinato këngë popullore dhe artistike të jë zëshe të cilat janë të përshtatshme nga përmbajtja, karakteri shprehës dhe ambitusi me aftësitë perceptuese dhe përjetuese të kësaj moshe</i></li> <li>▪ <i>Kultivojnë traditën muzikore kombëtare</i></li> <li>▪ <i>Në vegla muzikore (fëmijërore, të ORF-it dhe të tjera) interpretojnë shoqërime dhe kompozime të shkurtra instrumentale</i></li> <li>▪ <i>Ligjërojnë itmikisht vargje dhe i shoqërojnë ato me lëvizje të trupit dhe me vegla muzikore</i></li> <li>▪ <i>Aplikojnë teknikën elementare të të kënduarit dhe luajtjes instrumentale me formësim estetik</i></li> </ul>	<p><i>Me muzikë në vitin e ri shkollor.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Kujtimet muzikore nga pushimet</i></li> <li>▪ <i>Kori i shkollës</i></li> <li>▪ <i>Këngët popullore Begatia jonë</i></li> <li>▪ <i>Përmbledhja jonë e parë e këngëve</i></li> <li>▪ <i>Përmbledhja jonë tingëlluese</i></li> <li>▪ <i>Këndi muzikor</i></li> </ul> <p><i>Kohëzgjatja Muzikore</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Muzikën e masim</i></li> <li>▪ <i>Muzika përmban heshtjet dhe pushimet</i></li> <li>▪ <i>Urimet muzikore</i></li> <li>▪ <i>Këngë për ngjarje të veçanta</i></li> </ul> <p><i>Shtegtimi muzikor</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Këndojmë, interpretojmë, vallëzojmë</i></li> <li>▪ <i>Këngët dhe kompozimet më të dashura</i></li> </ul> <p><i>Muzika nga brezi në brez</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Këngë të vjetra, veglat dhe valët nga treva jonë</i></li> </ul>	<p><i>Zilja Jonë, F. Beqiri</i> <i>Dal nga dal po vjen behari (patriotike).</i> <i>Librat rrinë radhë radhë -didaktike</i> <i>Viti I Ri, V. Filaj</i> <i>B.Mulliçi, Pushimet dimërore</i> <i>Këngë Labe</i> <i>Biçikleta, D.Rudi</i> <i>Bleta – Didaktike</i> <i>Mësuesja ime, N.Kaba</i> <i>Pranvera</i> <i>Gjyshja, B. Shema</i></p> <p><i>Ligjërimet</i> <i>Tym tym koko tym</i> <i>Vjeshta</i> <i>Nina nana</i> <i>Ora</i> <i>Shiu pikëlon</i> <i>Rona rona</i> <i>I fuqishmi</i></p>
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>dallojnë ngjyra tingëllore nga natyra dhe krijimtaria artistike dhe me to shprehin përjetimet dhe imagjinimet e tyre</i></li> <li>▪ <i>interpretojnë në mënyrë të re këngë</i></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Interpretohen lëvizje në temp e në masë të kompozimeve që i këndojnë dhe i luajnë me vegla</i></li> <li>▪ <i>Zgjedhin veglën për interpretim ose shoqërim të këngës</i></li> </ul>	

<p><b>K</b> <b>R</b> <b>I</b> <b>J</b> <b>I</b> <b>M</b></p>	<p><i>dhe ligjërime ritmike në mënyrë përjetuese dhe estetike</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>sajojnë shoqërim me vegla muzikore fëmijërore për këngët dhe ligjërimet</i></li> <li>▪ <i>plotësojnë ritme dhe melodi dhe u përgjigjen pyetjeve muzikore</i></li> <li>▪ <i>krijojnë melodi të reja për vargjet dhe vargje për melodi</i></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Zgjedhje e lirë e lëvizjeve për muzikën e dëgjuar</i></li> <li>▪ <i>Imitimet muzikore</i></li> <li>▪ <i>Plotësojmë mendimet muzikore</i></li> <li>▪ <i>Pyetjet dhe përgjigjet muzikore</i></li> <li>▪ <i>Krijojmë përfytyrime muzikore</i></li> </ul>	
<p><b>D</b> <b>Ë</b> <b>GJ</b> <b>I</b> <b>M</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>dëgjojnë me vëmendje kompozime të ndryshme nga muzika programore dhe absolute</i></li> <li>▪ <i>shprehin përshtypjet e tyre mbi përjetimin muzikor</i></li> <li>▪ <i>përcjellin shfaqje muzikore</i></li> <li>▪ <i>përcjellin ngjarjet kulturore në mjedisin e tyre</i></li> <li>▪ <i>Vallëzojnë</i></li> </ul>	<p><i>Me muzikë në përralla dhe tregime</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Përralla nga baleti</i></li> <li>▪ <i>Përralla muzikore</i></li> </ul> <p><i>Muzika lëvizja dhe vallzimi</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Luajmë vallen</i></li> <li>▪ <i>Me lëvizje dhe vallzim shprehim përmbajtjet e muzikës</i></li> <li>▪ <i>Bisedat muzikore</i></li> </ul> <p><i>Me vëmendje dëgjojmë zërat</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Zërat e veçantë muzikorë – tingujt</i></li> <li>▪ <i>Tingujt sajojnë melodinë</i></li> <li>▪ <i>Kënga përmban tekstin dhe melodinë</i></li> <li>▪ <i>Instrumentet prodhojnë tinguj të lartë dhe të thellë</i></li> </ul>	<p><i>F. Beqiri Ninula (Piano)</i> <i>Z. Ballata Nënës (Kor)</i> <i>V. Gjini Variacione (Klarinetë dhe Piano)</i> <i>M. Kaçinari Loja e Bariut</i> <i>V. Beqiri: "744S" Kuartet saksofonash</i> <i>M. Mengjiqi "Valle" (perkusione, piano)</i> <i>Gj. Gjevelekaj Miniaturë Vallja e Qitëlisë (Popullore)</i> <i>F. Qerimaj: Kabavangonr. 2 (muz. labe violinë klarinetë, piano)</i> <i>R. Dhomi: Trio harkor</i> <i>A. Peqi Valle (flaut e piano)</i> <i>V. Tole "Ç'u mbush mali (kor, piano)</i> <i>Donius Milhaud- Pranvera (piano)</i> <i>P. Çajkovski Kënga napolitane (Piano)</i> <i>K.S. Sans Elefanti</i> <i>Strauss Radecky Marsh</i> <i>Verdi Rigoleto (Ladona Mobile)</i> <i>R. Schubert Valsi Skocez</i></p>

## UDHËZIME DIDAKTIKO-METODIKE

Edukimi muzikor në klasën III paraqet një vazhdimësi dhe thellim të disa komponenteve mësimore të cilat janë punuar edhe në klasët e mëparshme (1 dhe 2), sidomos në pikëpamje të përjetimit të dukurive të ndryshme muzikore . Në klasën e tretë vazhdon të prijë përjetimi i dukurive muzikore gradualisht, duke i inkuadruar elementet e notacionit grafik dhe simboleve si risi në fazën parapërgatitore për t'i njohur nxënësit me elementet e shkrimit –leximit muzikor . Me një planifikim të mirë, përmbajtjet programore nga veprimtaritë muzikore (interpretimi, dëgjimi dhe krijimi) të cilat u ofrohen nxënësve duhet të jenë në përputhshmëri me mundësitë e zhvillimit të tyre të përgjithshëm dhe atij muzikor në veçanti.

Mësimdhënia muzikore duhet të realizohet duke zbatuar shumëllojshmërinë në procesin mësimor në kuptim të kombinimit të veprimtarive bazë.

Mësimdhënësi do të zbatojë metoda dhe forma aktive të punës, të cilat garantojnë sukses në procesin edukativ-muzikor.

Veprimtaritë mësimore – muzikore (interpretimi, dëgjimi dhe krijimi) paraqiten të ndërlidhura dhe janë gati të pandashme, prandaj formulimi i njësive mësimore duhet të kombinohet me së paku dy veprimtari të ndryshme. Kjo duhet bërë, jo vetëm për shkak të natyrës së lëndës, por edhe t'u bëhet e mundshme nxënësve veprimtari aktive, varësisht nga aftësitë individuale të tyre.

Përmbajtjet programore mbështeten në:

1. Literaturën e përzgjedhur muzikore për dëgjim dhe interpretim;
2. Njohuritë, konceptet dhe ligjshmëritë muzikore, të cilat ndihmojnë në ngritjen e nivelit të arsimimit muzikor;
3. Informacionet për kulturën muzikore të mjedisit të nxënësit si dhe formimin e qëndrimit estetik dhe pozitiv ndaj krijimtarisë kombëtare dhe botërore.

## INTEPRETIMI

Interpretimi si njëra ndër veprimtaritë themelore muzikore që u ofrohet nxënësve realizohet përmes këndimit dhe luajtjes në vegla muzikore mbështetëse në:

- Interpretimin e këngëve dhe lojërave popullore, ligjërimeve ritmike;

- Interpretimin e këngëve artistike për fëmijë;
- Përjetimin e dukurive ritmike e melodike (masat, cilësitë e tingullit, krahasimi i tonalitetit dur dhe mol etj.).

Në këndim zbatohet të kënduarit sipas veshit( imitimi) duke respektuar individualitetin e nxënësve dhe gradualisht zbatohet përdorimi i elementeve të notacionit grafik dhe përmes simboleve. Mësimdhënësi duhet të ketë kujdes në ambitusin e nxënësve dhe të synojë vazhdimisht për këndim të drejtë dhe të bukur, duke respektuar pozitën e drejtë gjatë këndimit, frymëmarrjen e duhur, shqiptimin dhe artikulimin e saktë si dhe inkorporimin e ngjyrimin dinamik dhe shprehjes emocionale.

Luajtja me vegla parasëgjithash ritmike zbatohet në shoqërimin e këngëve ose e lidhur me lëvizjen dhe vallëzimin.

## DËGJIMI

Dëgjimi muzikor në klasën e tretë duhet realizuar duke iu përmbajtur objektivave të kësaj klase dhe duke synuar në dëgjim përjetues të shprehjes muzikore të veprës. Procedura metodike e dëgjimit duhet të realizohet me kujdes, duke pasur parasysh kohëzgjatjen përkatëse të veprës në funksion të përqendrimit të vëmendjes si dhe mundësinë për shprehje kreative në bazë të dëgjimit.

Dëgjimet duhet të jenë të shkurtra dhe të shpeshta. Dëgjimi i përsëritur i veprës u mundëson nxënësve të vërejnë dhe dallojnë gjithnjë mjete dhe elemente të reja nga shprehja muzikore. Gjatë dëgjimit duhet të insistohet në të vërejturit e mjeteve dhe formacioneve interpretuese, karakterin shprehës të veprës, ngjyrat e ndryshme tingëllore dhe elementet muzikore si ritmi, melodia , harmonia (në kuptim të diferencimit të tingëllimës në dur dhe mol). Mësimdhënësi bën përzgjedhjen e veprave për dëgjim nga shembujt e propozuar në programin mësimor, duke i ndërlidhur me përmbajtjet tematike dhe veprimtaritë e tjera (interpretimin, krijimin). Përgatitjet motivuese para dhe pas dëgjimit bëjnë të mundshëm dëgjim aktiv dhe të vëmendshëm.

## KRIJIMI

Aktivitetet krijuese në këtë klasë kryesisht realizohen përmes lojës kreative, e cila mbetet shfaqja më thelbësore e kreativitetit të tyre.



Lëvizja dhe vallëzimi paraqesin aktivitetet bazë përmes të cilave nxënësit shprehin përjetimet e tyre muzikore, por inkurajohet edhe shprehja figurative dhe gjuhësore (kushtet e punës krijuese, pozita e arsimitarit).

## **VLERËSIMI**

Mësimdhënësi bën vlerësimin e arritjeve të edukimit muzikor në mbështetje të kërkesave profesionale didaktike dhe psikologjike. Vlerësimi bëhet në kuadër të grupit, duke vlerësuar arritjet në zhvillimin muzikor individual të nxënësve në dëgjimin aktiv, interpretimin vokal-instrumental dhe punën krijuese.

Mësimdhënësi përcjell, evidencon dhe vlerëson aftësitë muzikore shkathtësitë interpretuese, dituritë informative, ndieshmërinë dhe interesimin e nxënësve.

Vlerësohet rinjohja dhe përjetimi i shprehjes muzikore në veprat e dëgjuara.

Interpretimi vokal dhe instrumental vlerësohet në bazë të përvetësimit të numrit të caktuar të këngëve dhe përmbajtjeve instrumentale, saktësisë melodike-ritmike dhe interpretimit të përjetuar. Vlerësimi duhet të jetë i baraspeshuar mes këndimit sipas veshit, tekstit notal dhe mënyrës së kombinuar gjithnjë duke pasur parasysh mundësitë individuale të nxënësve.

Mësimdhënësi duhet ta përcjellë dhe inkurajojë interesimin e nxënësit për shprehje kreative, në veçanti vlerësohet:

- rinjohja e veprave të dëgjuara;
- këndimi dhe luajtja instrumentale;
- diktimet melodike dhe ritmike;
- përgjigjet me gojë dhe me shkrim;
- prezantimi

Instrumente të tjera vlerësimi janë:

- testi,
- vetëvlerësim

Mësimdhënësi gjatë vlerësimit duhet të ketë parasysh standardet sipas nivelit dhe rezultateve të arritshmërisë në vartësi nga objektivat e parashtruar.

Puna me kor dhe orkestër është formë e veçantë dhe e obligueshme e edukimit muzikor në shkollën fillore, të mesme të ulët dhe të mesme të lartë. Në kor dhe orkestër marrin pjesë nxënësit me aftësi muzikore të theksuara dhe në bazë të interesit të tyre.

Këto forma të mësimdhënies muzikore paraqesin nivel të lartë interpretimi muzikor dhe e përfaqësojnë shkollën në të gjitha shfaqjet publike në shkollë dhe jashtë saj.

Puna me korin dhe orkestrën e shkollës, si bazë për formimin e jetës artistike, do të jetë e planifikuar dhe e matshme me orar. Mund të formohen kore edhe në nivelin e shkollës fillore dhe ora në kor zgjat sa ora mësimore, 45 minuta. Kjo punë e mësimdhëniesit llogaritet në normën javore mësimore të tij me fond javor prej 2 orë ( në nivelin e parë). Gjatë vitit shkollor kori përgatit dhe prezanton program me kriterë artistike – pedagogjike.

## HYRJE

**Edukata figurative**, këtë vit shkollor u bën të mundshme nxënësve mënyrën e perceptimit, përshkrimit dhe krijimit të trajtave natyrore e të krijuara nga njeriu, të rritë aftësinë e njohurive të përgjithshme dhe të mundësojë zbatimin funksional të segmenteve të tjera jetike. Mësimi dhe ngritja figurative për nxënësit e klasës së tretë ndihmon në zhvillimin e ideve kreative dhe nxitjen e imagjinatës për gjykim personal në kompleksivitetin e tërësisë hapësinore. Kjo lëndë gjithashtu ngrit vetëbesimin e nxënësve për punë të vazhdueshme vetjake e kolektive në zhvillimin e shkathtësive shprehëse dhe eksperimentim hulumtues;

- Mësimi figurativ tash arrihet përmes njohurive të fituara më parë në konstelacion të krijimeve personale dhe aftësive gjyquese për kategoritë e veçanta hapësinore;
- Procesi mësimor i Edukatës figurative arrihet me përkushtim aktiv të nxënësve dhe mësimdhënësit gjatë orëve mësimore në punë praktike e kërkimore, si dhe në përfëshirje aktive e interesim përmbajtësor të lëndës.

## QËLLIMET

Programi mësimor i lëndës së Edukatës figurative ka për qëllim:

- Avancimin dhe zgjerimin e njohurive figurative për krijimet dhe fenomenet hapësinore me trajta natyrore e artistike, si dhe përdorimin dhe emërtimin e ngjyrave parësore (bazike) e dytësore (të përfituara).
- Fitimin e njohurive dhe përvojave më praktike për realizimin e detyrave të shtruara dhe zhvillimin e shkathtësive kreative, për arrijten e rezultateve sa më të mira në punë krijuese dhe përdorim të mjeteve realizuese.

## OBJEKTIVAT

E përgjithshëm	Specifikë
<i>Nga përmbajtja programore e klasës së tretë, nxënësi do të jetë në gjendje:</i>	
➤ Të vështrojë dhe analizojë	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Hapësirën me forma, ngjyra e trajta përkatëse.</li> <li>• Modelet e zgjedhura për krijim.</li> </ul>
➤ Të njoh dhe zotërojë	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përvojat e mësuara më parë nga puna praktike dhe inspirimi.</li> <li>• Disa drejtime artistike për të përshkruar veprat e zgjedhura.</li> <li>• Materialin dhe mjetet e zgjedhura për krijim.</li> </ul>
➤ Të veçojë	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Momentet më impresive nga pamjet dhe dukuritë.</li> <li>• Krijimet figurative gjatë vizitës në muze apo galeri arti.</li> </ul>
➤ Të dallojë	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Llojet, madhësitë, dhe përbërjet e objekteve.</li> <li>• Dukuritë e shprehjeve vizuale.</li> </ul>
➤ Të krijojë	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shprehi pune dhe vetëbesim.</li> <li>• Punime sipas afinitetit personal.</li> <li>• Raporte komunikuese me shokët dhe mësimdhënësin.</li> </ul>
➤ Të komunikojë	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Me shenja vizuale dhe art të aplikuar.</li> <li>• Për imagjinatën kreative dhe punimet e artit.</li> </ul>

ORGANIZIMI I PËRMBAJTJES PROGRAMORE	
Kategoritë	Nënkategoritë
<b>I.</b> Të vërejturit dhe njohuritë	1. Relacionet në hapësirë.....( 4 orë ) 2. Raporti i formave.....( 4 orë ) 3. Përfshirjet sipërfaqësore.....( 4 orë )
<b>II.</b> Të shprehurit dhe kreativiteti	1. Vija.....( 8 orë ) 2. Ngjyra .....( 8 orë ) 3. Harmonia dhe kontrasti.....( 2 orë )
<b>III.</b> Analiza dhe vlerësimi	1. Degëzimi i artit.....( 3 orë ) 2. Komunikimi.....( 2 orë ) • Orë të zgjedhura .....( 2 orë )

## ORGANIZIMI I PËRMBAJTJES PROGRAMORE

### I. Të vërejturit dhe njohuritë

- ✚ **Udhëzim:** Aftësimi i nxënësve për vrojtim hapësinor, në forma dhe përbërje sipërfaqësore të objekteve si dhe njohja thelbësore e doktrinave artistike gjatë shtjellimit të punëve kreative

Nënkategoritë	Temat mësimore	Udhëzime	Rezultatet e pritshme
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Relacionet në hapësirë</b> (4 orë)</li> </ul>	<p>Njoftimi dhe zgjedhja e temave nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>❖ <b>Planet hapësinore;</b> më afër, në mes dhe më larg; (Shpjegimi dhe puna praktike me nxënës kur objektet e ndodhura më afër dallohen si më të mëdha).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>○ <i>Vizatim e ngjyrosje – 4 orë, (lapsi i butë, ngjyra druri, flomasterë, ngjyra uji etj.)</i></li> </ul>	<p>Nxënësit do të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Zhvillojnë aftësinë për dallim të relacioneve hapësinore në fushën e tyre pamore;</li> <li>• Vizatojnë dhe ngjyrosin punimet në mënyrë të lirë nga temat hapësinore;</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Raporti i formave</b> (4 orë)</li> </ul>	<p>Njoftimi dhe zgjedhja e temave nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>❖ <b>Madhësitë e formave;</b> të mëdha, të vogla.</li> <li>❖ <b>Ngjyrat e formave;</b> (Format më të afërta, ngjyrat më intensive dhe anasjelltas).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>○ <i>Vizatim e ngjyrosje – 2 orë, (lapsi i butë, ngjyra druri, flomasterë, ngjyra uji etj.)</i></li> <li>○ <i>Modelim-2 orë, (plastelinë, letër me ngjyra, tekstil etj.)</i></li> </ul>	<p>Nxënësit do të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Bëjnë dallimin dhe krahasimin e madhësive dhe ngjyrave në raport me forma.</li> <li>• Shprehen me punime formash dhe ngjyrash përkatëse.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Përfshirjet sipërfaqësore</b></li> </ul>	<p>Krahasimi i sipërfaqeve të ndryshme dhe punimi i ndonjë shembulli në</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>○ <i>Vizatim e ngjyrosje – 2 orë,</i></li> </ul>	<p>Nxënësit do të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• dallojnë dhe punojnë</li> </ul>

(4 orë)	bazë të: ❖ <b>Tonaliteteve të ngjyrave;</b> (në një sipërfaqe të caktuar ngjyra mund të jetë e plotë (100%), gjysmë e plotë (50%) dhe e intensitetit të ulët 20%). ❖ <b>Strukturave sipërfaqësore;</b> të objekteve në natyrë (të lëmuara dhe të vrazhda).	<i>(lapsi i butë, ngjyra druri, flomasterë, ngjyra uji etj.)</i> ○ <i>Kolazh -2 orë ngjitja e letrave shkëlqyese, fjetet e shkrepëses, kokrra orizi ose fasule etj.</i>	sipërfaqet me tonalitete të ngjyrave të ndryshme. • Pikturojnë e kolazhojnë një punim tematik.
---------	--	--	---

## II. Të shprehurit dhe kreativiteti

✚ **Udhëzim:** Të shprehurit dhe kreativiteti të nxënësit të kësaj moshe pasqyrohet përmes punës kreative nga motivet e zgjedhura për krijim dhe përvoja kreative e fituar më parë në përfitim të shkathësive të reja gjatë përdorimit të vijave, ngjyrave dhe efekteve të tjera realizuese.

Nënkategoritë	Temat mësimore	Udhëzime	Rezultatet e pritshme
• <b>Vija</b> (8 orë)	Përcaktimi i temave të zgjedhura në bazë të modeleve për vizatim: • <b>Peisazh;</b> • <b>Natyrë e qetë;</b> • <b>Portret;</b> • <b>Formë e aplikuar;</b>	○ <i>Vizatim 6 orë, (lapsi i butë, ngjyra druri, flomasterë, ngjyra uji etj.)</i> ○ <i>Modelim-2 orë, (plastelinë, shkopinj, tel i butë etj.)</i>	Nxënësit do të: • Dallojnë llojet e vijave kryesore në objekte dhe punime. • Vizatojnë peisazhe, natyrën e qetë dhe portrete nga modelet e zgjedhura. • Shprehen me vija, ngjyra e

			<p>mjete të tjera krijuese gjatë zbatimit të formave të zgjedhura.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>•</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Ngjyra</b> (8 orë)</li> </ul>	<p>Njohja dhe përshtatja e temave për punë praktike me anë të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>❖ <b>Ngjyrave parësore -bazë;</b> (e verdha, e kuqja dhe e kaltra).</li> <li>❖ <b>Ngjyrave dytësore -të përfituara;</b> (nga kombinimi i ngjyrave bazike).</li> <li>❖ <b>Ngjyrave neutrale;</b> (e bardha, e përhimta dhe e zeza).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>○ <i>Vizatim e ngjyrosje- 6 orë, (lapsi i butë, ngjyra druri, flomasterë, ngjyra uji, ngjyra pastele etj.)</i></li> <li>○ <i>Modelim-2 orë, (plastelinë, shkopinj, gurë të vegjël, letër me ngjyra etj.)</i></li> </ul>	<p>Nxënësit do të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mbajnë në mend ndarjet e ngjyrave.</li> <li>• Përfitojnë shkathtësi krijuese me anë të ngjyrave.</li> <li>• Veçojnë dhe krijojnë punime nga përjetimet e rastit në bazë të ngjyrave dominuese në ndonjë objekt.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Harmonia dhe kontrasti</b> (2 orë)</li> </ul>	<p>Ushtrime praktike për realizimin e një kolazhi të thjeshtë tematik në bazë të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>❖ <b>Materialeve me ngjyra;</b></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>○ <i>Kolazh, (përdorimi i letrave, tekstileve apo materialeve të tjera me ngjyra)- 2 orë.</i></li> </ul>	<p>Nxënësit do të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shprehen me shembuj kreativë gjatë ngjitjes së letrave ose materialeve të tjera me ngjyra.</li> </ul>

### III. Analiza dhe vlerësimi

- ✚ **Udhëzim:** Kjo kategori, këtë vit shkollor shtron nevojën e njohurive të para për degëzimin e artit vizuel në përgjithësi, si dhe rrit aftësinë e komunikimit masiv në relacione të ndryshme kohore e pamore.

Nënkategoritë	Temat mësimore	Udhëzime	Rezultatet e pritshme
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Degëzimi i artit</b> (3 orë)</li> </ul>	<p>Njohja me ndarjet e artit pamor në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Artin figurativ:</b> (vizatimi, piktura, skulptura, grafika).</li> <li>• <b>Artin e aplikuar:</b> (disejti grafik, disejti industrial, qeramika, tekstili).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>○ <i>Mësim teorik për ndarjen e artit-1 orë.</i></li> <li>○ <i>Demonstrim konkret me shembuj nga fusha e Artit figurativ e aplikativ-2 orë, (demonstrim me punime, fotografi, fotoslajde, internet etj).</i></li> </ul>	<p>Nxënësit do të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Tregojnë ndarjen e artit dhe së paku nga dy drejtime të fushave përkatëse.</li> <li>• Jenë në gjendje të thurin një analizë të shkurtër për ndonjë vepër.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Komunikimi</b> (2 orë)</li> </ul>	<p>Njohja dhe komunikimi në bazë të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>❖ <b>Shenjave dhe simboleve;</b> (shenjave në rrugë, dhe mjete të tjera komunikuese si në; libra, revista, posterë, simbole etj.)</li> <li>❖ <b>Pamjeve të lëvizshme;</b> (reklamat televizive, filmat e vizatuar etj.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>○ <i>Rikrijimi i shenjave, i simboleve sipas zgjedhjes së lirë – 1 orë; (laps ose ngjyra të zgjedhura).</i></li> <li>○ <i>Punime të shenjave e të simboleve-1 orë; (plastelinë, tel i butë, shkopinj, letra të ndryshme etj.).</i></li> </ul>	<p>Nxënësit do të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Komunikojnë dhe shprehin imagjinatën e tyre kreative në bazë të formulimit të tyre;</li> <li>• Njohin shenjat kryesorë të komunikimit dhe paraqitjen e tyre në punime;</li> </ul>



## QASJET NDËRLËNDORE DHE NDËRPROGRAMORE

- ✚ Edukata figurative ka qasje ndërlëndore e programore, me të gjitha lëndët e tjera mësimore. Përshkrimet ilustrative në tekste dhe mjete të tjera mësimore, u ndihmojnë nxënësve që më lehtë t'i kuptojnë njësitë mësimore, por gjithashtu thurjet tekstuale e ndihmojnë zhvillimin e imagjinatës dhe përcaktimin më të drejtë.
- ✚ Kjo lëndë ka qasje ndërlëndore e programore me gjuhën shqipe, matematikën, punë-doren, muzikën, edukimin qytetar, edukatën fizike, por gjithashtu edhe me historinë, gjeografinë, biologjinë, fizikën e lëndë të tjera nga nivelet më të larta.
- ✚ Edukata figurative është lëndë gjithpërfshirëse dhe përmes saj, të kuptuarit logjik mund të zbatohet në procesin mësimor, duke trajtuar të drejtat e fëmijëve, ruajtjen e mjedisit, të drejtat gjinore, të drejtat racore, etj.

## UDHËZIME DHE REKOMANDIME PËR PUNË PRAKTIKE

- ✚ Mësimdhënësi dhe shkolla duhet të angazhohen për pajisjen e kabineteve (klasave) me material, vegla e mjete konkretizimi. Sa më të pajisura të jenë këto kabinate ose klasa, aq më të suksesshme do të jenë rezultatet e pritshme.
- ✚ Shkolla duhet të sigurojë së paku hapësirën ekspozuese për punimet më të suksesshme të nxënësve, në mënyrë që inspirimi dhe motivimi për pjesëmarrje në këto përvoja të mbështetet në suksese dhe aktivitete të larmishme.
- ✚ Zbatimi i punës në grupe, do t'i motivojë nxënësit për bashkëpunim, tolerancë e disiplinë kolektive.
- ✚ Gjatë punës me nxënës, do të ketë dallime evidente në kuptimin e talentit të tyre, por mësimdhënia pedagogjike me udhëzime e rekomandime praktike do t'i inspirojë edhe nxënësit më pak të talentuar, në mënyrë që të mos shkaktohet demoralizimi dhe shkëputja e tyre nga lënda mësimore.
- ✚ Zgjedhja e temave më interesante në kuadër të planit dhe programit mësimor do të ndikojë në arritjen e rezultateve të kënaqshme të nxënësve gjatë orës mësimore.
- ✚ Mësimdhënësi, duhet të jetë aktiv gjatë orës mësimore, në mënyrë që të vëzhgojë dhe të korrigjojë aktivitetin e nxënësve dhe punën e tyre kreative.

## VLERËSIMI

- ❖ Vlerësimi i rregullt dhe përcjellja e kujdesshme e përparimit të nxënësve gjatë mësimit figurativ nxit dhe motivon përkushtimin e tyre më të madh në arritjen e rezultateve sipas objektivave të parashtruar.
- ❖ Meqenëse vlerësimi i nxënësve në këtë lëndë kryesisht bëhet duke u mbështetur në komunikimin e tyre joverbal, mësuesi duhet të ketë parasysh edhe angazhimin e nxënësve për zhvillimin e njohurive të tjera nga fjalori figurativ ose komentimin e dukurive të tjera hapësinore.
- ❖ Për këtë lëndë, vlerësimin objektiv duhet kërkuar në bazë të arritjeve nga:
  - Kreativiteti individual i shprehjes së lirë në zotërimin e trajtave më të sakta nga detyrat e parashtruara;
  - Aktiviteti dhe përfshirja e nxënësve në punë grupore ose ekspozita të ndryshme (shkolllore);
  - Orjinaliteti dhe qasja përkushtuese në përfundimin e punimeve.
  - Njohja e drejtimeve të artit vizuel si dhe komunikimi verbal për termat, dukuritë dhe analizat tematike etj.

## TEKSTET DHE MJETET E TJERA MËSIMORE

Me qëllim të lehtësimit të procesit mësimor, përveç teksteve mësimore, nevojiten edhe:

### *Mjetet dhe materiali mësimor si:*

- Revista, fotografi, ilustrime, simbole, posterë, piktura etj.
- Fotoslajde, kompakt disqe (CD), kasete etj.
- Adresa në internet ([www.art attack.com](http://www.artattack.com), [www.barbie.com](http://www.barbie.com)).
- Modele të ndryshme (lojëra, kukulla-modele, makete, forma gjeometrike etj.).
- Lloje letrash me gramaturë e ngjyra të ndryshme;
- Lloje ngjyrash (lapsa, akuarel, temper, pastel etj.);
- Brusha, ngjitës, gërshërë, plastelinë, kocka të ndryshme, sapunë, tel të butë me mbështjellje plastike, kokrra fasule, oriz, lloje makaronash, lloje tekstilësh, pambuk etj.

## HYRJE

Puna e dorës për klasën e tretë është vazhdimësi dhe zgjerim i njohurive paraprake nga kjo fushë dhe ka të bëjë me përvetësimin e njohurive dhe shkathtësive të nevojshme (puna me letër dhe karton, materialet dhe përpunimi i tyre, qepja, prodhimet bujqësore, njohja nga rreziqet, ndotja e mjedisit nga zhurmat) që parashihen për këtë nivel. Lënda e punës së dorës ndihmon në zhvillimin e gjithanshëm të nxënësve, duke zhvilluar aftësinë e tyre krijuese si dhe ato komunikuese.

Lënda ndihmon në formimin dhe në zhvillimin e koncepteve, si në punën e dorës, ashtu edhe në lëndë të tjera mësimore që zhvillohen në shkollë. Puna e dorës shërben edhe si mjet për të ruajtur trashëgiminë tonë kulturore.

## QËLLIMET

Qëllimet kryesore të punës së dorës të nxënësit janë:

- Zhvillimi i një shprehje pozitive të nxënësit ndaj shprehisë në punë dore dhe rëndësisë së saj.
- Familjarizimi me mjedisin dhe motivimi i nxënësve që njohuritë e nxëna t'i shfrytëzojnë në jetë.
- Inkurajimi i nxënësve për të marrë ndonjë nisiativë dhe veprim të pavarur, duke pasur parasysh rregullat themelore të sjelljes në grupe, varësisht prej llojeve të ndryshme të veprimtarive që zhvillojnë.

## OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Nxënësi duhet:

### **Të zhvillojë qëndrimet dhe vlerat**

- Në kuptimin e përparësive dhe kufizimeve që i ofron lënda.
- Në kuptimin e sjelljeve personale (të jetë kooperativ, i hapur, tolerant, i ndershëm, i vullnetshëm, kritik, me nisëtiavë, etj.)

### **Të kuptojë**

- Rëndësinë e përdorimit të materialeve sintetike si zëvendësim i materialeve natyrore.
- Rëndësinë ushqyese të frutave.
- Rëndësinë ushqyese të perimeve.

### **Të përshkruajë**

- Proceset e larjes, pastrimit dhe krehjes së leshit.
- Proceset e tjerrjes, ngjyrosjes dhe endjes së pambukut.
- Fazat e kultivimit dhe të përpunimit teknologjik të drithërave.
- Proceset teknologjike të përpunimit të bimëve agrikulturore.
- Burimet kryesore të rreziqeve nga pajisjet dhe instalimet e ndryshme elektrike.

### **Të zbatojë**

- Prerjen e materialeve përmes shembujve të ndryshëm, duke përdorur vegla përkatëse.
- Qepjen e modeleve të ndryshme, duke përdorur materiale.
- Proceset e mbjelljes dhe vjeljes së frutave dhe perimeve.

### **Të dallojë**

- Llojet e drithërave si grurin, misrin, elbin, thekrën etj.
- Llojet e përpunimit dhe konservimit të frutave dhe perimeve.
- Pajisjet dhe instalimet e dëmtuara dhe rrezikun që kanoset prej tyre.
- Disa nga mjetet shpërthyese që mund të hasen në objekte dhe terren të hapur.

- Substancat e rrezikshme për njeriun dhe mjedisin nga ato të parrezikshmet.

#### **Të demonstrojë shkathtësi mendore**

- Në marrjen e vendimeve të logjikshme (duke i zgjedhur informacionet, njohuritë dhe përfundimet relevante).
- Të kenë besim në vetvete dhe të rrisin besimin në aftësinë e tyre për punë artizanale.

### **ORGANIZIMI I PËRMBAJTJES PROGRAMORE**

KATEGORITË	NËNKATEGORITË	NR. I ORËVE	PËRQINDJA
<b>1. Puna me letër dhe me karton</b>	1.1 Fazat e prodhimit të letrës dhe kartonit	<b>6</b>	<b>16,22 %</b>
<b>2. Materialet dhe përpunimi i tyre</b>	2.1 Leshi 2.2 Pambuku 2.3 Materialet sintetike	<b>6</b>	<b>16,22 %</b>
<b>3. Qepja</b>	3.1 Matja 3.2 Prerja 3.3 Qepja	<b>6</b>	<b>16,22 %</b>
<b>4. Prodhimet bujqësore</b>	4.1 Drithërat 4.2 Bimët agrikulurore 4.3 Frutat 4.4 Perimet	<b>6</b>	<b>16,22 %</b>
<b>5. Njohja nga rreziqet</b>	5.1 Rreziku nga tensioni elektrik 5.2 Rreziku nga zjarri 5.3 Rreziku nga lartësia 5.4 Rreziku nga ashensori 5.5 Rreziku nga mjetet shpërthyes 5.6 Rreziku nga substancat kimike	<b>7</b>	<b>18,90 %</b>
<b>6. Ndotja e mjedisit nga zhurmat</b>	6.1 Zhurmat e prodhuara nga proceset teknologjike 6.2 Zhurmat e prodhuara nga njeriu	<b>6</b>	<b>16,22 %</b>

KATEGORITË	NËNKATEGORITË	PËRMBAJTJA PROGRAMORE	REZULTATET E PRITSHME	LIDHJA NDËR-LËNDORE
<b>1. Puna me letër dhe me karton</b>	<b>1.1 Fazat e prodhimit të letrës dhe të kartonit</b>	1.1.1 Prodhimi i letrës 1.1.2 Prodhimi i kartonit 1.1.3 Llojet e letrës dhe të kartonit 1.1.4 Vetitë e letrës dhe të kartonit 1.1.5 Punimi i modeleve nga letra dhe nga kartoni	<b>Nxënësi duhet të jetë në gjendje:</b> Të njohë procesin e prodhimit të letrës dhe të kartonit. Të klasifikojë llojet e letrës dhe të kartonit. Të identifikojë vetitë e ndryshme të letrës dhe të kartonit. Të modelojë objekte nga letra dhe nga kartoni.	Gjuhë amtare, arte të bukura dhe matematikë
<b>2. Materialet dhe përpunimi i tyre</b>	<b>2.1 Leshi</b>	2.1.1 Qethja 2.1.2 Larja 2.1.3 Pastrimi dhe krehja 2.1.4 Tjerrja 2.1.5 Ngjyrosja 2.1.6 Endja	Të njohë procesin e qethjes. Të përshkruajë proceset e larjes, pastrimit dhe krehjes së leshit. Të diskutojë për rëndësinë e tjerrjes, ngjyrosjes dhe endjes.	Gjuhë amtare
	<b>2.2 Pambuku</b>	2.2.1 Kultivimi 2.2.2 Vjelja 2.2.3 Tjerrja 2.2.4 Ngjyrosja 2.2.5 Endja	Të njohë procesin e kultivimit të pambukut. Të përshkruajë proceset e tjerrjes, ngjyrosjes dhe endjes së pambukut.	
	<b>2.3 Materialet sintetike</b>	2.3.1 Përfitimi i materialeve sintetike 2.3.2 Përdorimi dhe rëndësia e materialeve sintetike	Të kuptojë rëndësinë e përdorimit të materialeve sintetike si zëvendësim i materialeve natyrore.	

<b>3. Qepja</b>	<b>3.1 Matja</b>	3.1.1 Matja e materialeve të ndryshme	Të shpjegojë mënyrën e matjes dhe mjetet e matjes së materialeve për qepje. Të zbatojë matje të ndryshme të materialeve.	Matematikë, gjuhë amtare dhe arte të bukura
	<b>3.2 Prerja</b>	3.2.1 Prerja me gërshtë	Të zbatojë prerjen e materialeve përmes shembujve të ndryshëm, duke përdorur vegla përkatëse.	
	<b>3.3 Qepja</b>	3.3.1 Qepja e materialeve të ndryshme 3.3.2 Modelimi i objekteve të ndryshme me qepje	Të zbatojë qepjen e modeleve të ndryshme duke përdorur materiale, kapëse, pulla, etj., me vegla përkatëse. Të vë në zbatim masat mbrojtëse gjatë punës.	
<b>4. Prodhimet bujqësore</b>	<b>4.1 Drithërat</b>	4.1.1 Llojet e drithërave 4.1.2 Kultivimi i drithërave 4.1.3 Përpunimi teknologjik i drithërave	Të dallojë llojet e drithërave si grurin, misrin, elbin, thekrën etj. Të përshkruajë fazat e kultivimit dhe të përpunimit teknologjik të drithërave.	Gjuhë amtare, matematikë, edukatë fizike
	<b>4.2 Bimët agrikulturore</b>	4.2.1 Llojet e bimëve 4.2.2 Kultivimi i bimëve 4.2.3 Përpunimi teknologjik i bimëve	Të identifikojë llojet kryesore të bimëve agrrikulturore dhe mënyrat e kultivimit të tyre. Të përshkruajë proceset teknologjike të përpunimit të bimëve agrrikulturore.	

	<b>4.3 Frutat</b>	4.3.1 Llojet, kultivimi, përpunimi, konservimi dhe rëndësia ushqyese e frutave	Të identifikojë llojet e frutave dhe mënyrën e kultivimit të tyre. Të dallojë llojet e përpunimit dhe të konservimit të frutave. Të kuptojë rëndësinë ushqyese të frutave. Të zbatojë proceset e mbjelljes dhe të vjeljes së frutave.	
	<b>4.4 Perimet</b>	4.4.1 Llojet, kultivimi, përpunimi, konservimi dhe rëndësia ushqyese e perimeve	Të identifikojë llojet e perimeve dhe mënyrën e kultivimit të tyre. Të dallojë llojet e përpunimit dhe të konservimit të perimeve. Të kuptojë rëndësinë ushqyese të perimeve. Të zbatojë proceset e mbjelljes dhe të vjeljes së perimeve.	
<b>5. Njohja nga rreziqet</b>	<b>5.1 Rreziku nga tensioni elektrik</b>	5.1.1 Rreziku nga pajisjet dhe instalimet elektrike, trafostacionet, shtyllat elektrike, instalimet elektrike, pajisjet elektrike shtëpiake etj.	Të përshkruajë burimet kryesore të rreziqeve nga pajisjet dhe instalimet e ndryshme elektrike. Të zbatojë rregullat e përdorimit të drejtë të pajisjeve elektrike prizat, çelësat, poçat etj. Të dallojë pajisjet dhe instalimet e dëmtuara dhe rrezikun që kanoset prej tyre.	Gjuhë amëtare



	<b>5.2 Rreziku nga zjarri</b>	<p>5.2.1 Shtjellimi i shkaqeve të ndryshme për shpërthimin e zjarrit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Loja me shkrepëse dhe qirinj</li> <li>- Përdorimi i pajisjeve me gas</li> <li>- Loja me fishekzjarrë</li> </ul> <p>5.2.2 Masat preventive për parandalimin e shpërthimit të zjarrit</p>	<p>Të identifikojë shkaqet potenciale për shpërthimin e zjarrit.</p> <p>Të dallojë masat preventive për parandalimin e shpërthimit të zjarrit.</p>	
	<b>5.3 Rreziku nga lartësia</b>	<p>5.3.1 Lëvizja në objekte të larta</p>	<p>Të identifikojë rrezikun nga lëvizjet e pakujdesshme në pjesët e larta të objekteve të banimit, ballkone, kulme etj., si dhe masat preventive për mënjanimin e këtij rreziku.</p>	
	<b>5.4 Rreziku nga ashensori</b>	<p>5.4.1 Ndërprerja e energjisë elektrike</p> <p>5.4.2 Mbingarkesa e ashensorit</p> <p>5.4.3 Kujdesi për ashensor</p>	<p>Të identifikojë burimet potenciale të rrezikut nga ashensori në rastet e ndërprerjes së furnizimit me energji elektrike dhe të mbingarkesës së tij.</p> <p>Të dallojë ashensorin dhe pjesët e dëmtuara të tij si burim potencial i rrezikut.</p>	
	<b>5.5 Rreziku nga mjetet shpërthyes</b>	<p>5.5.1 Llojet e mjeteve shpërthyes me pamjet e jashtme të minave, bombave, granatave, fishekëve etj.</p> <p>5.5.2 Sjellja dhe veprimet që duhet ndërmarrë me rastin e</p>	<p>Të dallojë disa nga mjetet shpërthyes që mund të hasen në objekte dhe terren të hapur.</p> <p>Të vetëdijësohet për nevojën e informimit të personave zyrtarë për çdo dyshim për mjetet shpërthyes të</p>	

		kontaktit me mjete shpërthyes	zbuluara.	
	<b>5.6 Rreziku nga substancat kimike</b>	5.6.1 Substancat kimike të rrezikshme për jetën e njeriut	Të identifikojë disa nga substancat kryesore kimike që mund t'i hasë nxënësi në shtëpi, shkollë, terren të hapur etj. Të dallojë substancat e rrezikshme për njeriun dhe mjedisin nga ato të parrezikshmet. Të zbatojë mënyra të drejta të përdorimit të substancave kimike të ndryshme.	
<b>6. Ndotja e mjedisit nga zhurmat</b>	<b>6.1 Zhurmat e prodhuara nga proceset teknologjike</b>	6.1.1 Zhurma e shkaktuara nga repartet prodhuese, motorët dhe pajisjet e tjera dhe komunikacioni	Të identifikojë repartet, punishtet dhe pajisjet që prodhojnë zhurmë të lartë si punishtet provizore për përpunimin e drurit, të materialeve plastike etj., që gjenden pranë mjedisit jetësor. Të vetëdijësohet për dëmin që bën zhurma në shëndetin e njeriut.	Gjuhë amtare, muzikë
	<b>6.2 Zhurmat e prodhuara nga njeriu</b>	6.2.1 Loja e zhurmshme dhe në kohë jo përkatëse 6.2.2 Muzikimi dhe dëgjimi i muzikës me tone të larta	Të dallojë situatat kur njerëzit ose fëmijët e pakujdesshëm prodhojnë zhurmë në mjedisin jetësor. Të përpilojë orarin e lojës apo muzikimit në kohën kur më së paku pengon mjedisin jetësor rreth tij.	

## **VLERËSIMI**

Vlerësimi i të nxënësve bëhet në këto mënyra:

1. Vlerësimi i angazhimit të nxënësve gjatë realizimit të përmbajtjes programore
2. Vlerësimi i punës individuale
3. Vlerësimi i kontributit në punën grupore

## **UDHËZIME NË PËRDORIMIN E LITERATURËS DHE BURIMEVE TË TJERA MËSIMORE**

### **Literatura e propozuar**

1. Doracakë për punën me letër dhe me karton, prodhimet bujqësore, njohja nga rreziqet, ndotja e mjedisit etj.
2. **Erich Neuwirth**: “Spaß beim Forschen und Entdecken 2”, Veritas-Verlag, Linz, Austri, 2001.
3. **Schoiswohl · Jeide · Neuwirth** : “Spaß beim Forschen und Entdecken 3”, Veritas-Verlag, Linz, Austri, 2002.
4. **Schoiswohl · Jeide · Vogl**: “Spaß beim Forschen und Entdecken 4”, Veritas-Verlag, Linz, Austri, 2003.

### **Pajisjet dhe parakushtet e tjera të nevojshme**

1. Trajnime për arsimtarë
2. Kabineti i pajisur me materiale dhe mjete të konkretizimit

### **Kushtet minimale**

1. Trajnime për arsimtarë

## **UDHËZIME METODOLOGJIKE TË PËRGJITHSHME**

1. Qasja problemore në paraqitjen e temës/njesisë
2. Theksi në demonstrim dhe punë individuale dhe grupore
3. Inkurajimi i punës individuale dhe shkëmbimi i dijes dhe i shkathtësive, puna interaktive

## **ORIENTIMET PËR PUNË TË PAVARUR**

1. Puna grupore dhe individuale

## **HYRJE**

Me planin dhe programin mësimor të edukatës fizike dhe sportive për nxënësit e klasës së tretë të shkollës fillore është paraparë që të realizohen të njëjtat detyra që janë të përfshira edhe në planin dhe programin mësimor për nxënës të klasës së parë dhe të dytë.

Në bazë të kësaj, dhe duke u bazuar në kërkesat, rregullat, metodat, format organizative të punës mësimore, të cilat i kushtëzon didaktika e përgjithshme si dhe metodika e veçantë e edukatës fizike dhe sportive, kjo shkathtësi ka vlerë dhe rëndësi të posaçme për kultivimin dhe ruajtjen e shëndetit, sidomos të nxënësve të moshës prej 6-10 - vjeçare.

Me organizim dhe shfrytëzim të mirë të edukatës fizike dhe sportive, duke u mbështetur, posaçërisht në parimet mësimore, përveç ndikimit në zhvillimin e aftësive psikomotorike të nxënësve, do të arrihet edhe krijimi i shprehive për ruajtjen dhe kultivimin e të mbajturit drejtë të trupit si dhe përjetimi i veprimeve lëvizore nga aspekti ritmiko-estetik.

## **QËLLIMI**

Me përmbajtjet programore që janë hartuar dhe përfshirë në planin dhe programin mësimor për këtë klasë arrihet:

- aftësimi i nxënësve në aspektin e krijimit të shprehive lëvizore,
- arrihet përshtatshmëria e aftësive lëvizore, aftësive funksionale të organeve në organizmin e nxënësve,
- vazhdohet edhe më tutje në zhvillimin e aftësive kreative përmes lojës,
- vazhdohet në fitimin dhe krijimin e shprehive për mbajtjen drejtë të trupit,
- përjetim të këndshëm dhe pozitiv të edukimit fizik dhe sportiv,

- respektimin e të arriturave kulturore dhe shoqërore,
- krijimi i shprehive për veprimtari humanitare dhe shoqërore,
- inkurajimi i nxënësve për inisiativë dhe veprim të pavarur, duke pasur parasysh parimet themelore të mësimin.

## **OBJEKTIVAT**

Përmes përmbajtjeve programore të parapara që të realizohen me nxënës të klasës së tretë, duhet të arrihen këta objektiva:

- Zhvillimi trupor dhe zhvillimi i aftësive lëvizore dhe funksionale
- Fitimi, perfeksionimi i lëvizjeve natyrore dhe i diturive sportive
- Njohja e vetive teorike të mësimin
- Përjetimi i këndshëm gjatë edukimit fizik dhe sportiv

### ***Zhvillimi trupor dhe zhvillimi i aftësive lëvizore dhe funksionale***

- me lëvizje të zgjedhura të ndikohet në mbajtjen drejtë dhe rritjen e trupit,
- të vazhdohet me ndikimin maksimal në zhvillimin e aftësive motorike, duke i shfrytëzuar format e ndryshme të lëvizjeve, lojërave elementare, stafetave dhe poligoneve,
- zhvillimi i aftësive për orientim në hapësirë (TERREN), duke i përvetësuar pozitat e ndryshme të trupit nën ndikim të forcës dinamike të pozitës që e merr trupi,
- të ndikohet në zhvillimin e aftësive funksionale të organizmit të nxënësve,
- zhvillimi i aftësive për përvetësimin e elementeve ritmike dhe të vallëzimit,
- plotësimi i motiveve parësore të nxënësve që janë të nevojshme për lëvizje dhe lojë,
- të ndikohet në funksionimin e drejtë të shprehive higjienike sipas kushteve të jetesës.

### ***Fitimi, perfeksionimi i lëvizjeve natyrore dhe i diturive sportive***

- krijimi i bazës për përvetësimin e lëvizjeve që do të shërbejnë për zhvillimin dhe përsosjen e diturive sportive,
- njohja me pozitat e trupit dhe marrja e tyre në formë të pavarur,

- marrja e pozitive të trupit dhe ekzekutimi i lëvizjeve trupore në kushte të ndryshme,
- përjetimi i hareshëm gjatë shfrytëzimit të veglave si dhe gjatë manipulimit me rekuizita të ndryshme (topa, topta, litarë, shishe druri, rathë etj.),
- njohja dhe përvetësimi i elementeve bazë nga atletika,
- njohja dhe përvetësimi i elementeve bazë nga gjimnastika sportive,
- njohja dhe përvetësimi i teknikave të lëvizjeve në lojërat më topa,
- njohja e disa lojërave kreative,
- përvetësimi dhe ekzekutimi i lojërave elementare dhe i lëvizjeve ritmike,
- njohja dhe përvetësimi i teknikës së notit të lirë (krol) kalimi në not 25 m,
- njohja e sporteve dimërore,
- adaptimi i organizmit të nxënësve në kushte me ujë dhe borë.

#### ***Njohja e vetive teorike***

- të vazhdohet me njohjen dhe mënyrën e shfrytëzimit të veshmbathjes sportive,
- njohja e terreneve sportive dhe e objekteve, e veglave dhe e rekuizitave etj.,
- njohja dhe respektimi i rregullave gjatë organizimit të lojërave elementare dhe sportive,
- njohja dhe respektimi i kushteve dhe i parimeve themelore gjatë shfrytëzimit të objekteve sportive (sallat, terrenet sportive, oborri i shkollës-poligoni, pishina etj.),
- njohja dhe shfrytëzimi i kërkesave dhe i kushteve higjienike për ruajtjen e shëndetit.

#### ***Përjetimi i këndshëm gjatë edukimit fizik dhe sportiv***

- krijimi i bazës për motivim për shfrytëzimin e aktiviteteve trupore, duke arritur, më vonë, ta vlerësojnë rolin e tyre,
- plotësimi i kërkesave për lëvizje dhe përjetimin e tyre gjatë ekzekutimit,
- përmes lojës të arrihet motivimi i nxënësve si dhe kënaqësia gjatë të ushtruarit,

- përmes aktiviteteve trupore të arrihet vetëbesimi, shpirti luftarak, guximi dhe qëndrueshmëria shpirtërore,
- përjetimi i mësimit estetik dhe ritmik,
- zhvillimi dhe përjetimi i marrdhënieve të shëndoshta shpirtërore dhe kulturore mes nxënësve.

### **PËRMBAJTJET PROGRAMORE**

<b>Kategoritë</b>	<b>Nënkategoritë</b>	<b>Nr.orëve %</b>
1. Lëvizjet natyrore	Ecjet dhe vrapimet, kërcimet, ngjitja dhe bartja, varjet dhe zvarritjet	20 orë - 27%
2. Atletikë	Vrapimi, kërcimet dhe hedhjet	17 orë - 23%
3. Gjymnastika sportive dhe ritmike	- Ushtrime në dysHEME-akrobatik. Kërcimet Ushtrime në trarin gjymnastikor, ushtrime ritmike dhe vallet popullore	17 orë - 20%
4. Manipulimet me rekuizita	- Ushtrime me topa, shishe druri, rathë dhe shkopinjë	20 orë- 27%
5. Aktivitetet e tjera	Ushtrime formimi pa dhe me rekuizita, në çdo orë mësimi. - Shëtitje. Fushim dhe gara.	

## TREGUESIT THEMELORË TË PROGRAMIT

Kategoritë	Nënkategoritë	Përmbajtjet programore	Standardet e arritshmërisë
1. Lëvizjet natyrore	Ecjet dhe vrapimet	Ecje dhe vrapim në forma dhe pozita të ndryshme (hapa të shkurtër, të gjatë, të shpejtë, më ngadalë, në majë të gishtërinjve, në thembra, pozita lart, quq, ndenjor, shtrirë barkas, në ije, në shpinë etj.) - lojërat elementare dhe të stafetës.	Nxënësi duhet: Të forcojnë shkathtësit dhe shprehitë lëvizore të veprimeve më të përshtatshme dhe ritmikiht sipas aftësive të tyre në distanca të caktuara 20-30 m.
	Kërcimet:	Kërcim i litarit të shkurtër dhe pengesave të ndryshme (stoli dhe trari gjimnastikor, medicinbali,) drurët, gurët etj.	Të arrijë rezultate më të mira në krahasim me matjen e parë dhe gjatë vitit të dytë.  Të realizojë më përpikëri mënyrat e ngjitjes dhe të bartjes së peshave me një dhe dy duar.
	Ngjitja dhe bartja	Ngjitja nëpër vegla gjimnastikore të vendosura pjerrazi (stoli gjimnastikor, dërrasa, purtekët, litari, shkallët) drurët etj. Bartja e peshave të ndryshme (2-3 kg.) nëpër vegla gjimnastikore dhe në distanca 6-10 m.	Të realizojnë formë të drejtë dhe me përpikëri mënyrat e varjeve të lira dhe të përziera, duke iu përshtatur veglave që shfrytëzohen. Të formojë shkathtësi dhe shprehi lëvizore duke vepruar ritmikiht sipas aftësive të tyre në distanca të caktuara 6-8 m.
	Varjet	Varja e lirë dhe e përzier nëpër veglat gjimnastikore (unazat, hekuri,	



	Zvarritja	<p>paralelja, shpatullorja, shpinoret, litari, shkallët,) nëpër drunjë-lisa etj.</p> <p>- kalim nga varja e lirë në varje të përzier dhe anasjelltas.</p> <p>Zvarritja në mënyra të ndryshme dhe nëpër vegla të ndryshme (barkas, ijash, në shpinë, quq me ndihmën e këmbëve dhe të duarve, vetëm me njërin dorë dhe njërin këmbë, vetëm më këmbë, vetëm më duar etj.)</p>	
Atletika	<p>Vrapimet</p> <p>Kërcimet</p> <p>Hedhjet</p>	<p>Elementet e vrapimit normal dhe garues - vrapim nga starti i lartë në distanca 10, 20 dhe 30 m. - vrapim sipas ritmit. Gara në distancë 30 m.</p> <p>Kërcim së gjati nga vendi dhe me vrull, - kërcim mbi vegla në lartësi 60 cm. Gara në kërcim nga vendi në largësi.</p> <p>Hedhja e tophave 200 gr nga vendi dhe me vrull në gjatësi dhe në cakshenjë (me njërin dhe më të dy duart. Garë kush më larg, më gjatë dhe më saktë.</p>	<p>Të arrijë kohë më të mirë në krahasim me matjen e parë dhe në vitin e dytë.</p> <p>Të arrijë rezultate më të mira në kërcim së gjati nga vendi, në krahasim me matjen e parë dhe në vitin e dytë.</p> <p>Të arrijë rezultat sa më të mirë në hedhjen e tophave në gjatësi dhe në cak, në krahasim të rezultateve të më parme.</p>

Gjinnastika ritmike dhe sportive	Ushtrime në dysHEME	- Kapërdimi para dhe kapërdimi prapa, - vertikalia mbi shpatullore „Qiri“.	T’i kuptojë pozitat fillestare dhe të formojë shprehi lëvizore që i kërkojnë veprimet gjatë të ushtruarit.  Të arrijë rezultate më të mira në rritjen e përsosjes së shprehive lëvizore sipas ritmit që e kërkon teknika e ekzekutimit.
	Kërcimet	Kërcim mbi arkën suedeze në lartësi 60 cm.	
	Ushtrime mbi trarin e ulët	Ecje dhe vrapim nëpër tra, kthim për 180° dhe 360°, kërcim nga trari më trup në hark.	
	Ushtrimet ritmike dhe vallet popullore	-Kërcim gërshtë, drenushë, gallop, kthimet për 180° dhe 360°. - lojërat elementare me elemente të lëvizjes ritmike - vallja popullore nga rrethi shoqëror.	
Manipulimet me rekuizita	Me topa	Parimi, pranimi, driblimi (me duar, këmbë, kokë rekuizita etj.) Dëbimi i topit në lartësi, hedhja në gjatësi dhe në cak, pasimi në dyshe dhe treshe lojërat elementare me topa. - gara.	Të kryejë veprime të ndryshme lëvizore me topa, të godet në shenjë dhe t’i përvetësojë dhe t’i zbatojë rregullat gjatë lojërave - garave.
	Me rrathë	Xhonglimi dhe shfrytëzimi i rrathëve për ushtrime të formimit, lojërat elementare me rrathë.	

	Me shishe të drurit	Xhonglimi dhe shfrytëzimi i shisheve të drurit për ushtrime të formimit. Lojërat elementare dhe të stafetës. Xhonglimi dhe shfrytëzimi i shkopinjeve për ushtrime të formimit.	
	Me shkopinj	Lojërat elementare dhe të stafetës me shkopinj.	
Aktivitetet e tjera	Ushtrimet e formimit	Ushtrimet e formimit pa dhe me rekuizita në pjesën përgatitore të orës.	Të arrijë forcimin e shkathtësive lëvizore dhe të shprehive me veprime ritmike të përshtatshme të aftësive psikmotorike.
	Shëtitja dhe krosi	Tri shëtitje: vjeshtë, dimër dhe pranverë.	Të arrihet forcimi i shprehive dhe i shkathësive lëvizore si dhe adaptimi i organizmit në kushtet me borë.
	Dimërimi	7-10 - lojërat elementare në borë, rrëshqitja me saja dhe ski nëpër terrene të përshtatshme. Pastrimi dhe përgatitja e rekuizitave për rrëshqitje.	Të arrijë forcimin e shkathtësive dhe të shprehive lëvizore dhe të veprimit ritmik të kërkuara sipas teknikës së notit të stilit të lirë. Kalimi i distancës 5-8 m në not.
	Verimi	Noti 7-10 ditë: ushtrime për adaptim në rezistencën e ujit, frymëqitja, pluskimi, kërcimet në ujë, lojërat elementare, përvetësimi dhe përsëritja e teknikës së notimit, stili i lirë.	

## UDHËZIME METODOLOGJIKE TË PËRGJITHSHME

Duke u bazuar në karakteristikat biopsikomotorike të moshës së nxënësve të klasës së tretë, organizmi i tyre është më i aftë për t'i përballuar ngarkesat më të mëdha se organizmi i nxënësve të klasës së dytë, kështu që mësimdhënësi, në përputhje me aftësitë e nxënësve, gjatë organizimit të procesit mësimor, duhet të smadhojë kërkesat, konkretisht nëse në klasën e dytë nxënësit kanë vrapuar shpejt në distancë 20 m tani duhet të vrapojnë në distancë 30 m.

Zgjedhja dhe shfrytëzimi i ushtrimeve duhet të jenë të orientuara, përveç në aftësimin dhe në zhvillimin e aftësive psikomotorike-transformimit, edhe në përvetësimin dhe përsosjen e diturive, shkathtësive dhe shprehive lëvizore.

Përveç lojërave elementare, mësimdhënësi, në pjesën hyrëse të orës duhet të shfrytëzojë, në masë të madhe, edhe format elementare të ecjeve, vrapimeve, kërcimeve dhe zhagitjeve. Kurse në pjesën përgatitore duhet të përgatitet dhe të ushtrojë kompleksin e U.F. pa dhe me rekuizita, së pari, duke demonstruar ai vet. Ushtrimet duhet të jenë më të përbëra, me inensitet më të lartë, më të theksuar dhe në shumicën e rasteve të shfrytëzohen ushtrimet e formimit (U.F. - kompleksi) me rekuizita (topa, shkopinj, shishe të drurit, litar të shkurtër etj.). Një kompleks i U.F mund të shfrytëzohet në disa orë të mësimin.

Në pjesën themelore të orës mësimdhënësi duhet të shfrytëzojë ato forma të punës, metoda, mjete mësimore (vegla dhe rekuizita) duke iu përmbajtur dhe respektuar parimet mësimore, të cilat do të mundësojnë, së pari, përvetësimin e teknikës së ekzekutimit të detyrës lëvizore e pastaj edhe të ndikimit në transformimin e aftësive psikomotorike. Kjo arrihet duke e ndarë pjesën themelore në dy pjesë (formalisht). Në pjesën e parë duhet ushtruar në përvetësimin e njësisë mësimore, kurse në pjesën e dytë puna të organizohet në formë të lojërave apo të garave (lojërat elementare dhe të stafetës).

Gjatë organizimit të procesit mësimor të zgjedhen ato aktivitete motorike të cilat nxënësit i mundësojnë të shprehë aftësitë e tij kreative nga aspekti lëvizor, kurse gjatë organizimit të lojërave ose garave mësimdhënësi duhet të ketë kujdes se ato duhet të ndikojnë te nxënësit që ata të përjetojnë kënaqësi, hare, vetëbesim, dashuri ndaj shokut, respektim për fitore dhe përjetim të drejtë edhe ndaj disfatës në lojë. Efekti i organizimit të procesit mësimor të edukatës fizike dhe sportive do të jetë më i madh nëse mësimdhënësi do ta shfrytëzojë edhe muzikën.

**REZIME:** Nga e tërë kjo rrjedh se mësuesi (arsimtari i mësimit klasor) duhet të këtë parasysh:

- Qasjen e problemeve në paraqitjen edhe organizimin e procesit mësimor;
- Theks të posaçëm në demonstrimin dhe në punën frontale dhe grupore me nxënës;
- Motivim dhe inkurajim të nxënësëve për punë frontale, grupore dhe individuale, duke arritur aftësimin praktik dhe teorik.

## **KONTROLLIMI DHE VLERËSIMI I NXËNËSVE**

### **1. Vlerësimi i përhershëm i aftësive lëvizore**

- Pas çdo kategorie të përmbajtjes programore që është realizuar të bëhet vlerësimi i të arriturave dhe i rezultateve duke i ranguar nxënësit në tri grupe.

### **2. Kontrollimi - vlerësimi i veçorive antropometrike dhe i aftësive lëvizore së paku dy herë në vit dhe atë:**

- Kontrollimi i të mbajturit drejt të trupit
- Peshja e trupit (PT) - lartësia e trupit (LT)-antropometri.
- Vrapim 3X10 m (V 3x10 m)
- Hedhja e topit në largësi 200 g (HT-200g)
- Përplasja e topit për mur 25 sek (PTM-25 s.)
- Kërcim nga vendi në gjatësi (KVGJ)

Në bazë të përpunimit të rezultateve dhe të arritjeve-ndryshimit nga matja e parë të rangohen nxënësit në tri grupe, me qëllim që në të ardhmen të programohet puna sipas rangimit të nxënësve (përparimtarë, mesatarë dhe në nivel bazë-njëjtë).

## **LITERATURA**

B. Hasangjekaj, Edukata fizike dhe sportive 1, DORACAK, Prishtinë, 2004.

Grup autorësh, Edukata fizike dhe sportive 2, Prishtinë, 2004.

- B. Hasangjekaj, Metodika e edukatës fizike, Prishtinë, 1998.
- M. Koritnik, 2000 lojëra, Prishtinë, 1998.
- M. Pirc, Metodika shkollë shportne vzgoja, Lublana, 1995.
- M. Koshniçar, Edukata fizike e nxënësve të SH.F. I-IV, Prishtinë, 1968.
- Grup autorësh, Lojërat didaktike në kopshtin e fëmijëve, Tiranë, 1970.
- Grup autorësh, Edukata fizike në shkollë, Tiranë, 1973.



Tirazhi: 2000 copë  
E përgatiti për shtyp  
*SHTËPIA BOTUESE LIBRI SHKOLLOR* – Prishtinë  
U shtyp në Shtypshkronjën PRINTING PRESS - Prishtinë



Katalogimi në publikim – CIP  
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

371.214 (075.2)

PLANI dhe programi mësimor : Për klasën e tretë fillore /  
[Kryeredaktor Isuf Zeneli].- Prishtinë : Ministria e Arsimit, e Shken-  
cës dhe e Teknologjisë, 2005 (Prishtinë : “Printing Press”).- 141 fq. ;  
24 cm.

Rezime : fq. 140 - Literatura : fq. 140-141

**ISBN 9951-450-60-1**